In domestic law, jurisdiction over criminal offenses in the computer field will be resolved on the basis of the general rules on the appointment of the legal entity provided by the Code of Criminal Procedure. Territorial jurisdiction is determined, in turn, by the place where the criminal offense was committed or attempted or the place where the consequences occurred. Therefore, if the offense was committed in the territory of the Republic of Albania, the Albanian state exercises its jurisdiction over the issue.

In case the place is not known, the jurisdiction belongs, in turn, to the court of the place of residence or residence of the defendant. If the jurisdiction cannot be determined in any of these ways, the trial of the case belongs to the court of the place where the prosecution is located,

---

<sup>61</sup> These provisions are provided respectively in Articles 191 / a, 208 / a, 299 / a, 299 / b of the Code of Criminal Procedure.



which has first registered the criminal offense<sup>62</sup>. If the criminal offense was committed entirely abroad, then the jurisdiction will be determined respectively by the place of residence, residence, arrest or surrender of the defendant. In case there are more than one defendant, the case is processed by the court that is competent for the largest number of them. The Code of Criminal Procedure also contains a special regulation for the case when the criminal offense is partially committed abroad, which provides that if the criminal offense is partially committed abroad, the jurisdiction in this case is determined based on the general rules of territorial jurisdiction<sup>63</sup>. Article 35 of the Convention provides that each Party shall designate a contact point to operate 24 hours a day, 7 days a week in order to ensure the provision of immediate assistance for the purposes of investigations or trials of criminal offenses relating to systems and computer data or for obtaining evidence in electronic form for a criminal offense. Such assistance includes facilitation, or when permitted by local law and practice, by doing immediately:

- a) Providing technical assistance;
- b) The storage of records in accordance with Articles 29 and 30; and
- c) Taking evidence, providing legal information and the location of suspects<sup>64</sup>.

A Party's point of contact has the right to make notifications to another Party's point of contact on an expedited basis. If the contact point designated by one Party is not part of the body or bodies of the Party

---

<sup>62</sup> Article 76, Section II (Territorial Jurisdiction) of the Code of Criminal Procedure.

<sup>63</sup> Article 77 of the Code of Criminal Procedure.

<sup>64</sup> Article 35, paragraph 1 of the Convention on Cybercrime.

competent for the provision of mutual international assistance or extradition, the contact point shall ensure that it is able to coordinate with the relevant body or bodies on an accelerated base<sup>65</sup>.

Based on the provisions in the Convention, the Council of Ministers has issued decision no. 141, dated 22.2.2017 "On the organization and functioning of the National Authority for Electronic Certification and Cyber Security". This is the authority, which is responsible for overseeing the implementation of law no. 2/2017 "On cyber security" and serves as a point of contact and assistance at the national level in case of attacks or incidents in the field of cyber security.

The mission of this authority is to guarantee security for trusted services, in particular to guarantee the reliability and security of electronic transactions between citizens, business and public authorities, increasing the effectiveness of public and private services and e-commerce.

This authority sets minimum technical standards for the security of data and information networks/ computer systems of the information society, in accordance with international standards in this field, in order to create a secure electronic environment.

The purpose of establishing this authority is to create an institution that through the implementation of law and international technical standards with zero tolerance, creates trust for users of electronic signature, electronic identification, trusted services and increases security in information system networks in the Republic of Albania.

Albania, in the fight against cybercrime, along with developments in the field of information technology and the revolution on the digitalization

---

<sup>65</sup> Article 35, paragraph 2 of the Convention on Cybercrime.

of public services, has made continuous efforts to improve the legal framework for cyber security.

Thanks to this progress, Albania has improved in the Global Cyber Security Index compared to 2017, from 89, to 62, worldwide and 36 at European level<sup>66</sup>. However, this progress has not yet reached the scale and pace of change needed to stay ahead of the rapid movement and evolution that comes from various cyber threats. Undoubtedly, cyber-attacks are among the most important security threats to the modern world and therefore cyber security has become an important part of national security.

For this reason, the drafting of the "National Cyber Security Strategy 2020-2025" is a necessity for the establishment of appropriate institutional mechanisms, in order to increase the level of cyber security in the country.

---

<sup>66</sup> Reporting made in the National Strategy for Cyber Security 2020-2025, approved by Decision of the Council of Ministers no. 1084, dated 24.12.2020.

**References:**

1. Cyber Defense Strategy 2018-2020, Ministry of Defense.
2. National Strategy for Cyber Security and Action Plan 2020-2025, approved by Decision of the Council of Ministers no. 1004, dated 24.12.2020.
3. Law no. 8888, dated 25.04.2002 "On the ratification of the 'Convention on Cybercrime'".
4. Criminal Code.
5. Code of Criminal Procedure

**Rahim OMBASHI<sup>67</sup>**

**MASS MEDIA COMMUNICATION: THE PROGRESS  
OF DISCOURSES IN THE ALBANIAN LANGUAGE  
DURING ‘PANDEMIC RESILIENCE’**

**Abstract**

The concept of political style has begun to take its first steps in the Albanian language. The term borrowed from Carola Schoor helps for a deeper understanding of lectures during political appearances. The paper will decompose the components of the political style, which in the global aspect continues to be underdeveloped, decomposing the concept systematically from the beginning of the Covid-19 pandemic in Albanian-speaking areas, from February 2020, until the end of extinction spring 2021. While the foundations of journalism continue to be based on those four or five key principles: independence and impartiality of information, public interest in news, and verification of sources of information, in this period of time we are informed and consume information, which is transmitted to us in different ways compared to the early ones. Public information is carried out without passing the filter of journalists and formal newsrooms, leaving the reader / viewer to his or her own devices when it comes to quality information of interest to the public. The question of how functional styles influenced the coping of the medical situation, which was related to the situation of the campaign for the general parliamentary elections in Albania, in April 2021, serves as a working hypothesis, because fact-checking services or initiatives are

---

<sup>67</sup> Rahim Ombashi Associate Professor Doctor, Dean of Faculty of Humanities & Law, Beder University College, Tirana, Albania

a trend contemporary of particular importance in the time in which we live. Public communication and media coverage during the 'pandemic renewal' period encountered difficulties in disseminating information. The lack of preparation of the public with official scientific information, supported the uncertainty about the expectations, which gave way to false news about the cure, the symptoms of the disease and ways to avoid and cope with the COVID-19 virus. They even believed in 'non-paper' en masse, as 'infodemic' information grew, which helped a lot to obscure the danger posed by poor quality information. Based on primary facts and sources, the help given through functional styles will be analyzed, giving the proper answer to the hypothesis. There was a marked increase in the use of functional religious style because his vocabulary was particularly enriched, but more importantly helped to cure panic and reduce personal anxiety. Meanwhile, instead of a single style (journalistic-literary, journalistic), the political style clearly appeared as a combination and cooperation of three components or three sub-styles: rhetorical, social and ideological. There was difficulty in approaching the evaluation of the ideological sub-style, which was realized by the approximate method that reveals it by features, which can be stylized populist, elitist or pluralistic. In this period, the editorial appeared as a combination of analysis and opinion and as a caricature, a kind of figurative-publicistic art, which includes humor and satire, displayed through humorous elements, ridicule, irony and even political sarcasm. An analysis of the ideological style of the four speeches of Albanian politicians Edi Rama, Lulzim Basha, Monika Kryemadhi and Ilir Meta and of some writings of publicists within this style is performed. The close comparison of individual style profiles explains the differences and similarities, somewhat inexplicable, between the four politicians, as well as preaching journalism with amateur journalism.

**Keywords:** *Political style, Ideological-Rhetorical-Social component, Infodemic, 'Pandemic resilience', "non-paper", Political sarcasm, Stylizing in a Populist-Elitist-Pluralistic way*

## Hyrje

Koncepti i stilit funksional politik ka filluar të hedhë hapat fuqishëm në komunikim në gjuhën shqipe dhe po zë vend edhe në mediet, që komunikojnë në këtë gjuhë. Termi i marrë hua nga Karola Shur (Carola Schuur) ndihmon për një kuptim të thellë të ligjërimeve gjatë paraqitjeve politike. Kumtesa do të zërthejë përbërësit e *stilit politik*, i cili edhe në aspektin global vijon të jetë në zhvillim, duke shkoqitur konceptin hap pas hapi prej fillimit të pandemisë Covid-19 në trevat shqipfolëse, nga shkurti i vitit 2020. Analiza do të vijojë deri në prag të shuarjes së pandemisë, në fund të pranverës 2021, që përkon me mbarimin e zgjedhjeve të përgjithshme parlamentare të këtij viti në 25 prill. Ndërsa themelet e gazetarisë vazhdojnë të bazohen në ato katër ose pesë parime kryesore: pavarësia dhe paanësia e informacionit, interesi publik për lajmet, si dhe verifikimi i burimeve të informacionit, në këtë periudhë kohe informohemi dhe konsumojmë informacion, i cili na transmetohet në mënyra të ndryshme krahasuar me ato të hershmet. Informimi publik kryhet pa kaluar filtrin e gazetarëve dhe të redaksive formale, duke e lënë lexuesin / shikuesin / dëgjuesin (marrësin) në fatin e tij, kur bëhet fjalë për informacion cilësor me interes për publikun, informim të përzier të lajmit mbi shëndetin, i cili u përzie me lajmin politik.

Pyetja sesi ndikuan stilet funksionale tradicionale, përfshi stilin politik, në përballimin e situatës mjekësore, e cila u ndërlidh me situatën e zhvillimit të fushatës për zgjedhjet e përgjithshme parlamentare në Shqipëri, shërben si hipotezë e punimit, sepse shërbimet ose iniciativat e kontrollit të fakteve janë një prirje bashkëkohore me rëndësi të veçantë, në kohën në të cilën jetojmë. Komunikimi publik dhe mbulimi i medieve gjatë periudhës së ‘pandemic resilience (rinovimit pandemic)’ hasën

vështirësi në shpërndarjen e informacionit si dhe në mbajtjen gjallë të komunikimit. Mungesa e parapërgatitjes së publikut me informacion shkencor zyrtar, mbështeti pasigurinë në lidhje me pritjet, të cilat u lanë vendin lajmeve të rreme për kurimin, simptomat e sëmundjes dhe mënyrat për të shmangur dhe përballuar virusin COVID-19. U besuan masivisht deri dhe “non-paper”, ndërsa u rrit informacioni ‘infodemik’, i cili ndihmoi mjaft për të mjegulluar rrezikun që sillte informacioni me cilësi të dobët. Bazuar në fakte dhe burime parësore, do të analizohet ndihmesa e dhënë përmes stileve funksionale, të rinovuara tashmë, duke i dhënë përgjigjen e duhur hipotezës. Bie në sy që pati një fuqizim të dukshëm të përdorimit të stilit funksional fetar, fjalori i tij u pasurua veçanërisht, por më e rëndësishmja ishte besimi i përhapur si mbështetje, i cili ndihmoi në shërimin e frikës ekzistenciale, uljen e ankthit dhe panikut personal.

Kalohet në të nga ligjërimi përhumbës e trishtues, i tipit: “Unë nuk e di me kë jam, por e di mirë me kë nuk jam”, që kishte pllakosur gjithkund komunikimin, drejt shpresës që mposht pandeminë, duke u shtuar si rast i gjuhës shqipe:

Reagimi i plotë i Kryepeshkop, Anastas Janullatos: Kryepiskop i Tiranës, Durrësit dhe i Gjithë Shqipërisë; Pashkë 2021, maj: *Çlirim nga urrejtja dhe variantet e saj*

“Ditë e Ngjalljes, le të ndriçohemi me panairin... dhe ata që na urrejnë, le t’i falim të gjithë në Ngjalljen.” (Vargëzime të *Pashkës, Lavdia*)

E kremtja e të rëndritshme e Pashkës na fton plot hare të shkëlqejmë nga gëzimi, të çliruar nga robëria e pasioneve vdekjeprurëse, nga çdo element i errët, i fshehur në thellësinë e egos sonë.



Duke përfunduar:

... Duke u frymëzuar dhe duke marrë fuqi nga e krentja e tërëndritshme e Pashkës, që mbi të gjitha është e krentja e pajtimit universal, le të përpiqemi të paqësohemi personalisht, duke falur madje edhe ata që na urrejnë, edhe nëse kjo na duket e vështirë. Ngjallja e Krishtit shpall fitoren e jetës mbi vdekjen e mbi gjithë pasionet shkatërrimtare dhe na fton të shijojmë çlirimin tonë nga pushteti i tyre. Dhe në një botë që përpëlitet nga armiqësi vdekjeprurëse dhe nga pandjeshmëria, le të bëhemi luftëtarë kundër urrejtjes dhe varianteve të saj të shumëllojta. Dhe, me besim të palëkundur, le të përpiqemi që të forcohet bashkimi, pajtimi, dashuria, uniteti, bashkekzistenca harmonike e njerëzve dhe e popujve.

Krishti u ngjall, vëllezër dhe motra.

Me shëndet të fortë dhe shpresë gjatë periudhës së turbullt të pandemisë, dhe me lirinë e Ngjalljes në shpirtin tonë!

Në përgjithësi u trondit skepticizmi që është ngritur pothuajse në nivelin e ligjit natyror, ku vendin e Zotit e ka zënë një mori zotash dhe më i rëndësishmi është ai i progresit (Kopliku, Fatos A. 2021: 9, 10). Ndërkohë, në vend të një stili të vetëm (publicistiko-letrar, gazetaresk), u përvijua dukshëm stili politik, si një ndërthurje dhe bashkëpunim i tre përbërësve apo tri nënstileve: *retorik*, *social* dhe *ideologjik*. Vështirësi gjatë punimit dolën në qasjen për vlerësimin e nënstilit ideologjik, e cila u tejkalua me metodën e përafërt që e zbulon atë nga tiparet, të cilat mund të stilizohen në mënyrë *populiste*, *elitiste* ose *pluraliste*. Kryhet një analizë e nënstilit ideologjik të katër fjalimeve të politikanëve shqiptarë Edi Rama, Lulzim Basha, Monika Kryemadhi dhe Ilir Meta, si dhe e disa shkrimeve të publicistëve brenda këtij stili. Krahasimi i imët i profileve të stilit individual jep një sqarim të dallimeve dhe ngjashmërive, deri-diku të pashpjegueshme, midis katër politikanëve, si dhe diferencon publicistikën predikuese krahasuar me atë amatore.

Analiza e informacionit infodemik ndihmoi shumë për të sqaruar rrezikun, që vinte nga komunikimi publik me cilësi të dobët.

Gjatë periudhës nga marsi i vitit 2020 deri në qershor 2021, mbizotëruan reklamat e ndërtuara sipas ligjërimit gazetaresk dhe të paguara nga tregu farmaceutik, informacioni i paketuar nga propaganda, i kryer gjithashtu me të njëjtin stil funksional gjuhësor. Ato rritën frikën për efektet anësore të vaksinave dhe, së bashku me teoritë e konspiracionit rreth tyre, lanë një pjesë të publikut larg vaksinimit. Nuk munguan shkrimet e hartuara në ligjërimin funksional tekniko-shkencor, i cili ofronte siguri jo vetëm për të prekurit nga pandemia, por gjithashtu u vinte në ndihmë atyre që po mjekoheshin, ose atyre që rrezikonin të prekeshin. Urdhra dhe udhëzime u shfaqën përmes ligjërimit juridiko-administrativ, që nuk ishin pak, por njohja e stileve funksionale, përfshi stilin politik, mundëson që publiku të filtrojë vetë informacionin, domethënë të mos besojë në lajmet e përjetshme (Kur?) dhe burimin (KU?), por të kuptojë qëllimin e përhapjes së tyre. Duke mbështetur forcimin e të menduarit analitik dhe qëndrimin kritik, ndihmohen zgjedhjet e informuara, sepse sasia e madhe e informacionit, tani vetëm një klikim larg, mund të jetë e padobishme, nëse dikush nuk edukohet dhe mëson profesionalisht sesi të marrë lajmet.

... ..

I gjithë Ballkani, sot, veçmas Ballkani Perëndimor, përballen me informimin e turbullt e deri atë fals, offline e online, që vërshon me shumicë dhe përhapet me shpejtësinë e informacionit infodemik. Publiku “bombardohet” me ngulm nga njoftime me cilësi të dyshimtë, aq sa shpesh është e vështirë të kuptosh diferencën mes lajmeve të rreme dhe

propagandës, historive të njëanshme apo informacionit të besueshëm. Pandemia e shkaktuar nga Covid 19, që nisi të përhapet zyrtarisht një vit më parë, tregoi qartë sesa e brishtë është audienca kundrejt shtrembërimit të fakteve, lajmeve të rreme, që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në shëndetin e individit, i cili përballej me to. Mbulimi mediatik dhe informimi i publikut gjatë një krize shëndetësore, të ndërthurur me atmosferën e mjedisit politik në përgatitje apo në zhvillim të zgjedhjeve parlamentare, është gjithnjë një sfidë, por në kushtet e një pandemie botërore, në kohën e internetit, filtrimi i informacionit bëhet edhe më i vështirë.

Të gjitha ato premise të silogjizmave ekzistenciale shtuan frikën ndaj efekteve anësore të vaksinave dhe bashkëshoqëruar me teoritë konspirative rreth tyre, trembën dhe lane larg një pjesë të publikut. Nuk munguan shkrimet e hartuara në ligjërimin tekniko-shkencor, që jepnin siguri jo vetëm për të prekurin nga pandemia, por erdhën në ndihmë edhe të atij që po kurohej, apo atij që rrezikohej të prekej nga epidemia botërore. Në ligjërimin juridiko-administrativ përcilleshin pa kursim urdhëra e udhëzime në mbështetje të zgjidhjes së situatës së rënduar, ndërkohë që stili funksional i komunikimit fetar u pasurua me leksik të panjohur për publikun e gjerë duke u bërë aktiv.

Nga mediet e vendase mësohet që më tetë mars 2020, Shqipëria pohoi dy rastet e para me Koronavirus (Covid-19): një baba dhe një djalë, i biri, të cilët kishin ardhur në vend nga Firenze e Italisë. Në të njëjtën ditë, qeveria urdhëroi ndalimin e të gjitha fluturimeve si dhe tragetet, që vinin nga zona veriore e Italisë, deri më tre prill. U mbyllën për dy javë shkollat, u urdhërua ndalimi në publik i të gjitha grupimeve të njerëzve si dhe iu kërkua zyrtarisht federatave të sporteve të pezullonin


aktivitetet. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) njoftoi se çdo person që hyn në Shqipëri nga zonat me karantinë të Italisë duhet të vetizohet, ose do të ndëshkoheshin. Në mesditën e 11 marsit u shënua vdekja e parë nga Koronavirusi në Shqipëri; një grua 73-vjeçare vdiq në Durrës nga komplikime vaskulare. Më 12 mars, një zëvendësministër i Shëndetësisë deklaroi se gjatë 24 orëve të fundit 145 njerëz u ishin nënshtruar testeve për COVID-19. Nga të dhënat e marra u rrit numri i të infektuarëve në 23, 18 prej të cilëve ishin asimptomatikë dhe në vetizolim, kurse pesë ndodheshin të shtruar në spital. Mediet saktësonin se të 23 personat e infektuar kishin histori udhëtimi në Itali ose kishin rënë në kontakt me njerëz që kishin qenë në atë vend.

Ministria gjegjëse njoftoi në datën 13 mars se numri i të prekurve me Koronavirus kishte shkuar në 33, e dhënë kjo pas 159 testeve të reja të kryera në 24 orët e fundit. Po në atë ditë, qeveria njoftoi mbylljen e qyteteve të mëdha, përfshirë edhe Tiranën, deri të dielën në mesnatë. Disa nga masat e tjera të marra ishin bllokimi i rrugëve, ndalimi i qarkullimit të makinave private dhe mbyllja e të gjitha bizneseve (me përjashtim të farmacive dhe dyqaneve ushqimore). Të gjithë shtetasit e huaj, që donin të shkonin në aeroport, duhej të merrnin leje me shkrim nga policia për të përdorur rrugët. Deri në 17 mars janë dëshmuar 55 raste, nga të cilët 25 persona ishin të shtruar në spital, ndërsa tre prej tyre ndodheshin nën mbikëqyrje të fortë. Në 24 orët e fundit u testuan 42 persona, nga të cilët katër prej tyre rezultuan positive, duke e çuar numrin e të infektuarëve nga 51 në 55. Te materiali i paraqitur më lart, i cili është mbledhur nga informacioni zyrtar i atyre ditëve, mbizotëron stili funksional politiko-shoqëror, i cili qëndron midis atij të letërsisë artistike dhe stilit tekniko-shkencor. Bie në sy leksiku i zgjedhur dhe

fjalët me kuptim të drejtpërdrejtë, leksik nga fusha të larmishme të veprimtarisë njerëzore dhe shprehje ndërkombëtare: *Koronavirus (Covid-19), karantinë, vetizolim, virus, komplikime vaskulare, teste, asimptomatikë, rezultuan pozitivë, etj.* Vendin kryesor e zënë fjalët me ngjyrim shoqëror, togfjalësha të karakterit mjekësor: *Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, komplikime vaskulare, zonat me karantinë, shtruar në spital, nën mbikëqyrje të fortë, mbyllja e qyteteve, mbyllja e bizneseve, etj.* Njoftimet nga Instituti i Shëndetit Publik (ISHP) apo Ministria rreken të jenë të thjeshta, të qarta, pa stërgjatje e dykuptimësi, sepse u drejtoheshin masave të gjera të popullsisë, që prisnin njoftimet zyrtare me ankth. Shumë shpejt lexuesi dhe dëgjuesi u mësua me fjalët ndërkombëtare si: *Koronavirus (Covid-19), karantinë, testim pozitiv, testim negativ, etj.*, që u futën në fjalorin aktiv të kohës.


Gjatë ‘pandemic resilience’, term i përdorur si kundërshti ndaj pritshmërisë absurde mbi ardhmërinë humane, periudhë që zyrtarisht nisi në mars të vitit 2020, industria e marketingut iu përshtat dinamikës së pandemisë në vitin 2020 e në vijim, duke e bërë prirje popullore ‘dhurimin’ apo ‘lojërat shpërblyese’ (giveaway), ndërsa gjithçka tjetër vërtitej rreth rrjeteve sociale dhe ‘e-commerce’. Komunikimi digjital i ka shtuar hapësirat dhe biznesi e pa atë si kanal të rëndësishëm komunikimi, duke investuar atje fort për të zënë sa më shumë konsumatorë. Sipas ekspertëve të fushës, Covid-19 nxiti kreativitetin duke nxjerrë në pah market me vizion të qartë. Ndërkohë, pa marrë parasysh gjendjen e rënduar shëndetësore në vend, të dy kahjet e sistemit politik: pozitë-opozitë përgatiteshin për të filluar fushatën e zgjedhjeve të përgjithshme parlamentare. Edhe brenda njoftimeve shëndetësore, ndihej fryma politike, të paktën te leksiku. Më shumë sesa specialistët

dhe institucionet e specializuara për shëndetin, njoftimet i bënin individë të lidhur ngushtë me politikën, që ndonëse përpiqeshin të mos përdornin parulla ideologjike dhe leksik politik, e gjen atë te filozofia ku mbështetjeron informacioni që jepnin, por dhe te redaksionali, si zhanri publicistik që shpreh opinionin e redaktorit, redaksional-shkruesit a botuesit (Lamb, J. 1985: 23). Në këtë periudhë kohe, redaksionali u shfaq si ndërthurje e tij me analizën dhe opinionin edhe si karikaturë, lloj ky i artit figurativ-publicistik, ku përfshihet humori dhe satira, shpërfaqur përmes elementesh qesëndisëse, talljes, ironisë e deri sarkazmës politike. (Gogo, V, 2020: 25.) Ndërkohë u shpeshtua dukshëm dalja offline në organet e shtypit karikatura e realizuar me skica të fotove të personazheve politikë, të dalluar në parapërgatitjen apo zhvillimin e fushatës zgjedhore politike (Gazeta *Dita* apo *Tema*).



*Mapo*, 13 April 2020

Shifrat e COVID-19, Karikatura e ditës në MAPO nga Bujar Kapexhiu  
“PO ULE KURBËN, OR BURRË, ULEE!”



Mapo, 11 June 2021

“Dora e bashkëpunimit”, karikatura e ditës në MAPO nga Bujar Kapexhiu

Ndërkohë u shfaq shpesh në organet e shtypit karikatura e realizuar me skica të fotove të personazheve politikë, që spikatën në parapërgatitjen apo zhvillimin e fushatës zgjedhore politike të vitit 2021 (Gazeta *Dita* apo *Tema*).

Tensioni politik mes dy kampeve kundërshtarë, sikur zbutej në dukje, kur në mediet shfaqej informacioni ekonomik, që kryesisht ishte mes redaksionalit dhe reklamës së barnave, të cilat kishin mbërritur në Shqipëri për të mposhtur apo parandaluar, sipas tyre, pandeminë.

Në këtë periudhë kohë u rrit edhe më autoriteti i këtij lloj informacioni (redaksi-reklamuese ‘advertoriali’), që në prapavijë i shërbente pozitës politike, e cila e lidhi fort mbijetesën e vet me luftën kundër pandemisë. Po të kemi parasysh përcaktimin e Marshall McLuhan, të dalluar dhe

përzgjedhur nga Walter Lippman, se reklamat janë lajme, veçse lajme që përhapin gjithnjë lajme të mira, kuptohet edhe këtu, pse ndërsa farmacitë dhe industria e tillë fitonte sa nuk thuhet, pozita fitonte hapësirë në parapërgatitjen apo gjatë zhvillimit të fushatës politike.

***“Deviral” mbërrin në Shqipëri, përdoret si anti-viral edhe kundër Covid-19***

Viti 2020 ishte një vit i pazakontë për të gjithë shqiptarët dhe jo vetëm. Njerëzit në mbarë botën u përballën me pandeminë e Covid-19, e cila infektoi miliona persona si dhe shkaktoi miliona viktima, sipas të dhënave të Worldometer:

“Shkon në 3 milionë numri i viktimave nga Covid-19 në të gjithë botën (Deri në datën 16 prill 2021)

Numri i viktimave të shkaktuara nga koronavirusi në të gjithë botën tashmë ka shkuar në 3 milionë. Më konkretisht, që nga fillimi i pandemisë e deri më sot, e kanë humbur jetën 3,002,524 njerëz në të gjithë planetin. Ndërsa, numri i të infektuarëve qëkur kanë nisur të mbahen shifrat rezulton të jetë 139,8 milionë, prej të cilëve 118,8 milionë janë shëruar. Vendi me shifrat më të larta është SHBA ku numërohen 32,2 milionë të infektuar dhe 579,008 viktima. Situata kritike duket në Indi pasi vendi është goditur nga një valë e dytë edhe më vdekjeprurëse se e para për shkak të ekzistencës së varianteve. Numri i të infektuarëve është rreth 14,3 milionë, kurse ai i viktimave 174,335. Vendi i tretë më i prekur nga pandemia është Brazili ku numërohen 13,7 të infektuar dhe 365,954 raste fatale. Raste aktive në të gjithë botën janë 17,9 milionë prej të cilave, 17,8 (99.4%) po e kalojnë sëmundjen me simptoma të lehta dhe 106,820 (0.6%) janë në gjendje serioze ose kritike.”

Në vendin tonë u morën masa të rrepta për frenimin e përhapjes së koronavirusit si dhe u këshilluan njerëzit sesi të kujdeseshin për shëndetin e tyre, duke nisur nga ushqimet, vitaminat dhe ilaçet që mund



të merrnin gjatë kësaj periudhe aspak të zakonshme. Dhe një nga barnat që mund të përdoret si anti-viral dhe kundër Covid-19 është “Deviral”, që ka mbërritur edhe në Shqipëri.

***Pse duhet të përdorni Deviral?***

- Lehtëson gjendjet gripale dhe infeksionet virale
- Përmirëson sistemin imunitar dhe rrit mbrojtjen natyrore të trupit kundër viruseve dhe baktereve
- Mbron qelizat nga stresi oksidativ
- Ndhmon në reduktimin e lodhjes dhe dobësisë
- Ky anti-viral është shumë i mirë kur je i prekur nga Covid



Deviral të ndihmon që të fuqizosh imunitetin si dhe të rrit forcën e brendshme. Medikamenti lufton viruset dhe infeksionet akute. Substanca aktive, andrografold është një përforcues i vërtetë i fuqisë së sistemit tonë imunitar. Kapsulat bio-informuese natyrore “Deviral”, përmbajnë barëra që përdoren për të luftuar shumë viruse në mjekësinë alternative. Ky ilaç ka veti të konsiderueshme anti-virale dhe janë kështu të domosdoshme gjatë “sezoni të gripit”.



Prej përbërjes së tij, ky medikament ndihmon në ruajtjen e pastërtisë së tërë organizmit. Efektet e saj pozitive bimore ilustrohen gjithashtu nga përforsimi i funksionit të mëlçisë në hepatit, përmirësimi i shikimit dhe ulja e rrezikut të reaksioneve alergjike.

Ai është gjithashtu efektiv në trajtimin e diarresë, sëmundjeve gastrointestinale, si dhe në uljen e etheve dhe përmirësimin e përgjithshëm të frymëmarrjes. Për një trup të shëndetshëm, merr “Deviral” tani dhe aktivizo fuqishëm imunitetin tënd.

### **Qendra ALERT – Alert.al**

Nënstili i botuar nga redaksionali reklamues, ndihet që përvijohet me tipare populiste, i është shmangur shkrimi profesional, që duhet të jepte saktë rezultatet e pritshme pas marrjes së këtij preparati, që nuk dihet ku është pranuar e miratuar zyrtarisht si i tillë.

Gjatw rreth njw viti e gjysmw qw kemi marrw nw analizw, pati shkrime qw futen lehtw te nwstili retorik. Pwr ilustrim zgjodhwm shkrimin e publicistit Kim Mehmeti: *Nga politika s’pasurohet ai që e mbron, por ai që e shet ç’i takon popullit*, 26/04/2021, Portali syri.net, kurse si shembull i shkrimit tw pwrgratitur me nwnstilin social pwrzgjodhwm

artikullin nga Erion Dasho: *Çfarë peshon më tepër, 400 mijë të vaksinuar apo 10 mijë të vdekur?! 25/04/2021, Portali syri.net.*

Më e dukshëm bëhet dallimi i nënstilit ideologjik të fjalimet e politikanëve. Meqenëse tradicionalisht, stili politik ishte thjesht një çështje bindjeje: duke ndjekur “Retorikën” e Aristotelit, politikanët duhej të rregullonin paraqitjen e tyre sipas audiencës që kishin para, në mënyrë që të ishin efektivë. Për shembull, një audiencë e ndodhur në kushtet e pandemisë dhe për më tepër e drejtuar për dy legjislatura prej po asaj force politike apo në krye të një koalicioni partiak, kërkon një stil tjetër nga një më i hershmi për të fituar legjislaturën e tretë 2021-2025, por dhe bashkëbiseduesit e arsimuar mund të joshen me një stil apo nënstil tjetër funksional nga dëgjuesit më pak të shkolluar (Aristoteli, 1984: [360–355 para Krishtit], 1390 a 25)

Meqenëse politikanët e çdo krahu nuk mund të jenë kurrë një kopje e njerëzve që përfaqësojnë, ata duhet të kapërcejnë ndryshimin në mënyrë krijuese, ashtu si një piktor gjatë kompozimit të një portreti (Ankersmit, 1996: 49–56; Pels, 2003: 49). Ankersmit dhe Pels bëjnë dallimin midis një qasjeje ‘mimetike’ dhe ‘estetike’ për demokracinë. Sipas tyre, një qasje mimetike mohon zbrazësinë që e mbush artisti dhe për këtë arsye është në kundërshtim me natyrën përfaqësuese të demokracisë. Në një qasje estetike, politikanët kërkojnë lidhje me një grup njerëzish përmes një stili dhe shije të përbashkët, pa sugjeruar që të jenë identikë (Ankersmit, 1996: 49–56; Pels, 2003: 49).

Për stilizimin e tyre nga dikush tjetër, në publicistikën tonë politike ka disa modele. Në një të tillë, shkruar në janar të vitit 1949, në burgun e Tiranës, Hafiz Ibrahim Dalliu hodhi vargjet e titulluara: “Drejtësia e

sundimtarëve të sotshëm”, të cilat i ruajti dhe i fshehu me kujdesin më të madh:

Po kërkoje dritën, të-japin errësirën.  
Po deshe shijen, të japin të vështirën...

Duket shkrimtarin e shquar dhe klerikun konsekuent energjia e brendshme e ndihmon të mbrojë besimin, që të forcojë durimin, kësisoj atij i rritet e i zmadhohet shpresa te e ardhmja, duke mos u njësuar me të. Kurse në fjalimin e mëposhtëm, Kryeministri Rama mëton se e ka mbushur zbrazëtinë me ndjekësit që po e dëgjojnë e shohin në takimin përmbyllës të fushatës elektorale, ndonëse në kohë pandemie, kur dihet që nuk është kështu. Zbrazëtia mbushet i bindur që ndjekësit e po të njëjtit këndvështrim dhe pozicionim politik, po marrin atë që do t'i drejtojë tek kutia e votimit, duke u vetëstilizuar si elitist-populist:

Edi Rama në mbylljen e fushatës në Tiranë: “Ata janë rruga e së shkuarës, PS është e ardhmja”

Partia Socialiste e Shqipërisë ka përmbyllur këtë të enjte fushatën e saj elektorale për zgjedhjet parlamentare të 25 prillit në qarkun Tiranë. Kryeministri i vendit, Edi Rama përpara kandidatëve për deputetë, fillimisht fjalën e hapi duke përgëzuar punën e patronazhistëve, ndërsa hodhi akuza të forta ndaj kundërshtarëve politikë në lidhje me ngjarjen e djeshme në Elbasan. Ai tha se diferenca mes PS dhe partive të tjera është shumë e thellë dhe për këtë kërkoj nga mbështetësit që me 25 prill të votojnë selinë rozë.

“Pasi e gjitha Shqipëria u trondit nga humbja e një jete, morën përsipër t’u thonë shqiptarëve se po, ata e kanë “një grup të armatosur të shpërndarë kudo”. Unë besoj se sot kush ende nuk e ka kuptuar diferencën e madhe mes jush dhe atyre, duhet t’i vërë gishtin kokës fort për fëmijët e tij”, tha Rama. Për shefin e qeverisë, Partia Socialiste është dera e të ardhmes së Shqipërisë

dhe kjo është arsyeja pse qytetarët duhet të zgjedhin partinë që ai drejton.

“Ata janë rruga e së shkuarës, Partia Socialiste e Shqipërisë është dera e të ardhmes. Në 25 prill është dita jo për të bashkuar kënaqësitë tona, por për të bashkuar të gjithë pakënaqësitë tona dhe për t’i thënë njëri-tjetrit se ka plot arsye për të qenë të pakënaqur me ata që kemi bërë”, theksoi Rama. Ai nuk kurseu as Presidentin e Republikës, Ilir Meta, për të cilin tha se është “turpi i të gjithë shqiptarëve”.

“Në 25 prill çojeni në shtëpi Ilir Metën. Boll, mjaft! Ilir Meta është turpi ynë, i të gjithë popullit shqiptar. Është turpi më i madh që Shqipëria ka mundur të ketë atje në krye. Ai turp duhet zhbërë më 25 prill dhe turp kush voton Ilir Metën. Ka vetëm një numër, që jeni ju, është numri 12. Numri 12 jeni ju”, - tha ai.

Një vetëstilizim të tillë të ngjashëm ka dhënë media duke u mbështetur te fjala e prijësit të opozitës së bashkuar, duke e dalluar gjithashtu si elitist-populist:

Kryetari i PD-së, Lulzim Basha, mbajti fjalim aty ku e pikënisoi dhe fushatën e tij para zgjedhjeve elektorale të 25 prillit. Ai ka shprehur gjithë kënaqësinë dhe ngazëllimin që ka marrë nga gjithë rrugëtimi i takimeve elektorale në çdo qark, qytet, familje anëmbanë Shqipërisë.

Kryetari Basha iu drejtua jo vetëm simpatizantëve të pranishëm, por edhe publikut të gjerë. Sipas tij, kjo ëndërr do të bëhet realitet vetëm nga pjesëmarrja e tyre në votimet e 25 prillit, që do të jenë pika e kthesës për t’u bërë ëndërra e tyre, që ta shohin Shqipërinë në zemër të Evropës. Sakaq, zotimi dhe vullneti i tij politik riafirmohet si një vullnet për ndryshim, ashtu siç, në thelb ka qenë edhe motoja e aleancës, fushatës dhe e Partisë Demokratike.

Ai ka premtuar fitoren më të thellë, sepse sipas tij në këto 8 vite kryeministri Rama ka vjedhur e grabitur pasurinë e shqiptarëve dhe ëndrrat e tyre.

“Kjo nuk është Tirana e Edi Ramës, por e juaja dhe kështu do të jetë gjithmonë. E gjitha kjo do të provohet më 25 prill nga vota dhe vullneti juaj”, - shtoi Basha.

“Në këtë shesh ushtojnë zërat e demokratëve dhe demokrateve, qytetarëve e qytetareve, simpatizantëve e simpatizanteve, e sidomos atyre që na ndjekin nga shtëpia, mirëserdhët në bashkimin e shqiptarëve”, - ishte një nga thirrjet e kryetarit të Partisë Demokratike, Lulzim Basha.

Jo rrallë herë, ai ka përsëritur së bashku me të pranishmit se zgjidhja dhe alternativa e 25 prillit është numri 9.

“Të gjithë ata që do të votojnë më 25 prill, nuk do të jenë shërbëtor të askujt përveçse të ligjit”, - deklaroi Basha.

Stilizimi pluralist i kryetares së partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, Monika Kryemadhi, nga ana e medieve, është mjaft afër së vërtetës duke analizuar fjalën e mbajtur në fund të zhvillimit të fushatës elektorale, madje qysh prej titullit: “Më 25 prill votoni për t’i dhënë fund tranzicionit”

Lëvizja Socialiste për Integrim ka mbyllur sot fushatën elektorale në Qarkun e Tiranës. Në një miting të zhvilluar në sheshin “Nënë Tereza”, kryetarja e LSI, Monika Kryemadhi bëri thirrje që qytetarët më 25 prill të votojnë për t’i dhënë fund tranzicionit:

“Shqipëria është sot në rrezik është e tradhtuar nga qeverisja prandaj në këto zgjedhje u bëj thirrje të gjithë juve nga ky shesh i bekuar që të mos ndaloni për asnjë moment në këto ditë për të çuar çdo njeri drejt kutisë së votimit për të votuar LSI”, tha ajo.

Sipas znj. Kryemadhi qeveria e re do të kujdeset për ndryshimin e klimës së biznesit duke favorizuar biznesin e ndershëm dhe jo oligarkët që siç tha ajo janë “kthyer në shtojzovalle për të ruajtur paratë dhe koncesionet që u grabisin paratë shqiptarëve”.

“Lista e LSI është lista fituese dhe këtë e tregon sot kjo pjesëmarrje e jashtëzakonshme në sheshin ‘Nënë Tereza’. Më 25

prill shqiptar kanë në dorë zgjidhje të zgjedhjeve të tyre, më 25 prill shqiptarët do të votojnë për ndryshimin duke votuar numrin 6, pasi ne kemi vënë zemrën për Shqipërinë”, deklaroi kryetarja e LSI-së.

Monika Kryemadhi u bëri thirrje të gjithë qytetarëve që më 25 prill t'i kthejnë Shqipërisë sovranitetin me votë dhe për të pasur një Shqipëri evropiane.

Si vetëstilizim tipik populist, në vijim të prezantimeve të tilla të bëra më herët, media ka dhënë një deklaratë të Presidentit të Republikës vetëm një javë para zhvillimit të votimeve për të zgjedhur parlamentin e vendit, 2021 (është shkurtuar, por pa prekur sidomos stilin):

Deklaratë e Presidentit të Republikës, Ilir Meta

Të nderuar qytetarë të Republikës së Shqipërisë,

Edhe një javë na ndan nga zgjedhjet e historike të 25 prillit, ku të gjithë bashkë në mënyrë të barabartë duhet të ushtrojmë të drejtën më themelore, por njëkohësisht dhe detyrimin më të rëndësishëm që kemi ndaj të ardhmes sonë, për 100 vitet e ardhshme. Atdheu ynë Shqipëria, por dhe bashkëkombësit tanë në rajonin tonë, ndodhen në një moment shumë të rëndësishëm, të përcaktimit të rrugës së sigurtë dhe të pandryshueshme të integritetit, dhe konsolidimit të së ardhmes sonë vetëm në Bashkimin Evropian.

Si President i Republikës, ndiej detyrimin që t'ju përcjell paraprakisht këto mesazhe dhe kam këto kërkesa ndaj jush si qytetarë të Republikës së Shqipërisë, pa asnjë dallim partiak

– Kjo javë e fundit, duhet të shoqërohet nga një klimë zgjedhore më e qetë dhe më bashkëpunuese. Por edhe më ballafaquese, në kuptimin e transparencës para qytetarëve nga të gjithë. Ftoj të gjithë qytetarët dhe politikanët, të distancohen nga çdo fenomen negativ që nxit urrejtjen, që provokon dhunën, dhe mbi të gjitha që dëmton rëndë integritetin e këtij procesi zgjedhor historik.

– Të gjithë qytetarët me të drejtë vote, duhet t'u drejtohen qendrave të votimit, për të ushtruar të drejtën e tyre, në mënyrë të qetë, të lirë dhe të fshehtë, dhe të refuzojnë çdo përpjekje që do

synonte shtrebbërimin e vullnetit të tyre... Ky është themeli i drejtësisë që kërkohet të gjithë qytetarët e Shqipërisë.

– Çdo qytetar, duhet të votojë i lirë, për të zgjedhur atë që mendon se është më i miri, për atë që mendon se mund t'i përfaqësojë më mirë, për atë që i bind se e ardhmja tyre do të jetë më e sigurt për ta dhe për familjarët e tij.

– E ardhmja jonë e përbashkët si shqiptarë, për 100 vite që vijnë nuk mund të blihet, me asnjë çmim...

– Asnjë pushtet nuk është më i fortë se vota e lirë dhe referendare. Çdo pushtet, buron prej saj, dhe çdo e drejtë kushtetuese mbrohet vetëm prej saj... Ata nuk janë patronazhistë. Patronazhist është etiketim i kohëve tona. Janë 'fuksat' që ka njohur populli shqiptar për 50 vite gjatë regjimit të kaluar. Memet që shpërndahen forcërisht në rrjetet sociale, për ta marrë këtë historinë e patronazhistëve "si me të qeshur", sigurisht që janë të papërgjegjshme... E gjitha kjo është një skemë skandaloze dhe nuk është aspak problem, sepse këtë gjë e ka bërë edhe Gestapo. Por, kjo skemë do të sqarohet në ditët që vijnë. Si President i Republikës, përveçse efekteve aktuale të këtij veprimi mafioz dhe të papërgjegjshëm me të dhënat e qytetarëve tanë, jam edhe i shqetësuar për pasoja afatgjata, të cilat kanë të bëjnë për çështje të siguriisë dhe të drejtave e çdo qytetari në këtë vend. Në një shtet të së drejtës me demokraci funksionale, reagimin institucional duhet të shoqërohej me numrin e arrestimeve, faljeve publike dhe dorëheqje. Të gjithë bashkë do të duhet që në datën 25 prill, të rivendosim në funksionim të gjithë mekanizmat e shtetit të së drejtës. Të rikthejmë në funksionim parimet themelore të Republikës që janë dhunuar rëndë, dhe në këtë mënyrë të rivendosim demokracinë dhe vetë rendin kushtetues! Vetëm përmes garantimit të ushtrimit të drejtës themelore të votës, dhe realizimit të zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, do t'i japim fund krizës së legjitimitetit dhe të përfaqësimit, që ka përfshirë institucionet kryesore të shtetit, do të zhbllokojmë çeljen e negociatave me Bashkimin Evropian dhe do të garantojmë se do të qeverisemi sipas vullnetit real të sovranit...

Përgatituni, keni një javë kohë që të votoni me kthjelltësi, me integritet, të lirë e të pa kapur nga askush. Vetëm kështu do të mund të ç'kapim shtetin tonë, e mbi të gjitha ju do të rifitoni të



gjitha të drejtat dhe liritë kushtetuese, që u janë cenuar rëndë gjatë viteve të fundit.

Për vetëstilizimin e çdo politikani analizuam vetëm gjuhën, kur dihet që elementi tjetër i rëndësishëm i identitetit politik është edhe kultura politike e gjithsecilit, që shpërfaqej deri dhe me gjestet politike të shtetarëve gjatë Pandemisë. Por duke u përpjekur të gjejmë tiparet populiste, elitiste apo pluraliste, brenda nënstilit ideologjik, sa më të pastra, nuk harruam për asnjë çast porosinë e paqtë të Xhejms Kliffordit (James Clifford), që parandalon gjetjet ‘e çmendura’.

Ajo gjithçka që mbeti pas analizave të imta prej ‘ndërmjetësimit kulturor’ kishte filluar të hibridizohej dhe të ndërthurej me tipare të tjera brenda nënstilit, që iu shtuan atij origjinal, ashtu natyrshëm, pa kufizime dhe përjashtime gjuhësore apo kulturore, duke u bërë më të begata e më të shëndetshme.

Këto tipare të nënstilit ideologjik duke kapërcyer dhe rrafshuar gjerdhet e vëna nga studiuesit, qofshin ato të vetëm këtij nënstili apo të dy të tjerëve: retorik apo social, që ngre pa kursim teorizmi i stileve funksionale, kanë gjetur arsyet më të thella të shtysës së tyre identitare, historikisht dhe natyrisht hibride. Ashtu siç na kujtohet me urtësi te termi ‘ndërmjetësim kulturor’, i marrë hua prej Kliffordit, ato arritën të hibridizohen dhe të ndërthuren me kultura të tjera, që iu shtuan asaj origjinale, ashtu natyrshëm, pa kufizime dhe përjashtime teorike, duke u bërë më të begata e më të shëndetshme, sepse nuk ndoqën ‘ideologjinë e pamend të pastërtisë’, sugjeruar herët nga Branko Merdani (Ombashi, Rahim. 2020: 23).

**BIBLIOGRAFI**

Ankersmit, F. (1996) *Aesthetic Politics: Political Philosophy beyond Fact and Value*, Stanford, CA: Stanford University Press.

Aristotle (1984) *Rhetoric* (trans. Rhys Roberts). In: Barnes J (ed.) *The Complete Works of Aristotle: The Revised Oxford Translation*. Princeton, NJ: Princeton University Press, pp. 2152–2269.

Arnol'd, I. V. (1969) *Stylistics of Heard Speech or The Stylistics of Decoding*, The Max Thorez Institute, in March.

Clifford, James. (1988) *The Predicament of Culture: Twentieth-Century Ethnography, Literature, and Art*, Cambridge, Mass.: Harvard University Press.

Clifford, James. (2012) "Feeling Historical." *Cultural Anthropology* 27, no. 3: 417–26.

Clifford, James. (2013) *Returns: Becoming Indigenous in the Twenty-First Century*, Cambridge, Mass.: Harvard University Press.

Clifford, James & George Marcus, eds. (1986) *Writing Culture: The Poetics and Politics of Ethnography*, Berkeley: University of California Press.

Dalliu, Hafiz Ibrahim. (2000) *Vepra Letrare*, Botime Enciklopedike, Tiranë, fq. 93-95.

Dalliu, Hafiz Ibrahim. (1949) *Drejtësia e sundimtarëve të sotshëm*, Tiranë.

Dasho, Erion. (2021) *Çfarë peshon më tepër, 400 mijë të vaksinuar apo 10 mijë të vdekur?! 25/04/2021 Portali syri.net*.

Galperin, I. R. (1973) *The system of functional styles*, on Mr. Rudnick's review of "Stylistics" style, vol. 7, Spring 1973, no. 2: A rejoinder.

Gogo, Valmora. (2020). *Editoriali në shtypin shqiptar*, Tiranë, f. 25.

- Kopliku, Fatos A. (2021) *Kurora mbi krye të përunjur – Përsiatje mbi Fenë, Folklorin dhe Shkencën*, Tiranë.
- Lamb, Jane. (1985) *The Complete Newspaper Resource Book*, pps. 23, J. Weston Walch Publisher, Portland Maine.
- Lippman, Walter. (2010) *Liberty and the News*, Dover Publication, USA, p.234-235.
- Mehmeti, Kim. (2021) *Nga politika s'pasurohet ai që e mbron, por ai që e shet ç'i takon popullit*, 26/04/2021, Portali syri.net,
- Moffitt, B (2016) *The Global Rise of Populism: Performance, Political Style, and Representation*. Stanford, CA: Stanford University Press.
- Ombashi, Rahim. (2020) *Historik i shtypit periodik shqiptar - (Sprovë për një poetikë historike)*, Tiranë.
- Schoor, Carola (2017) *In the theater of political style: Touches of populism, pluralism and elitism in speeches of politicians*, Discourse & Society, Vol. 28, No. 6 (November 2017), pp. 657-676.
- Van Dijk, TA. (2015) Ideology, In=Mazzolevi G, Barnhurst K, Ikeda K., et al. (eds) *The International Encyclopedia of Political Communications*, London, Wiley-Blackwell, pp. 495-505.

**Sajmir Bata**<sup>68</sup>

## **COVID-19 AND THE RESPECT OF HUMAN RIGHTS**

### **Abstract**

The purpose of this paper is to present how the covid-19 pandemic has affected respect for human rights and freedom. Numerous studies, reports from European and international institutions, as well as the jurisprudence of the courts (especially the Strasbourg court), have proven that the pandemic has had an impact on human rights.

The Strasbourg Court in its jurisprudence has concluded that states should take measures to protect themselves from the pandemic, but states should not violate fundamental freedoms and rights, as these are based on democratic order and human values. Of course, the courts of the states, through their court decisions, are of great importance, as they establish justice in the country and further prevent the violation of rights. To the question whether human rights and freedoms were affected in Albania from the announcement of the pandemic and its progress until the middle of June, we will answer with the laws that explain this very well. The qualitative methodology has helped to clarify through it all that belongs to individuals even in such extraordinary conditions.

In the period of the pandemic, it is important that the judiciary does not violate the rights of citizens. Individuals should have the opportunity to go to court for any legal or constitutional violations they allege. Delays in judicial services indicate shortcomings in respect for human rights and freedoms, the rule of law and democracy. It should be emphasized that everyone should be given the right to go to court, and to get their rights, at any time, even in times of pandemic.

**Key words:** *Covid-19, Human rights, Strasbourg Court*

---

<sup>68</sup> MSc. Sajmir Bata  
Zyra juridike pranë KMSH

## 1. Ndikimi i Covid-19 tek të drejtat e njeriut

Të drejtat e njeriut janë shumë të rëndësishme, andaj askujt nuk mund t'i cënohen këto të drejta, pasi përbëjnë thelbin e qenies njerëzore. Po çfarë janë dhe kujt i takojnë liritë dhe të drejtat e njeriut?

“Të drejtat e njeriut janë të drejta morale të patjetërsueshme. I takojnë njëlloj çdo personi për vetë faktin se është njeri, pavarësisht nga raca, kombësia ose përkatësia në një grup të dhënë shoqëror” (Simoni 2001).

Është e detyrueshme që shteti t'i sigurojë çdo individ të drejtat e njeriut, pasi këto të drejta përcaktojnë “kushtet minimale për dinjitetin e njeriut dhe për një jetë të pranueshme” (Simoni 2001).

Respektimi dhe zhvillimi i të drejtave të njeriut gjatë periudhës së Covid-19, ka qenë, është dhe do të jetë, një nga sfidat madhore globale të shoqërisë njerëzore. Të drejtat e njeriut gjatë periudhës së pandemisë së Covid-19, janë zbehur për nga rëndësia e tyre, pasi shoqëria njerëzore ka qenë e papërgatitur dhe institucionet shtetërore botërore janë zënë në befasi. Pandemia së bashku me pasojat që rrjedhin prej saj, si: padija, frika dhe përhapja globale e saj, keqinformimet, distancimi social, kontraditat shkencore, teoritë kontradiktore, rënia e besimit tek qeveritë etj, kanë ushqyer gjithnjë e më shumë cënimin e të drejtave të njeriut, rënien e nivelit të demokracisë dhe nxjerrjen në pah të vështirësive institucionale shtetërore, lidhur me menaxhimin dhe përballimin e krizave.

Covid-19 ka ndryshuar disi mënyrën e perceptimit, lidhur me liritë e të drejtat e njeriut. Pandemia ka dhënë mundësinë që këto liri dhe të drejta të kufizohen më shumë se më parë. Sfida më e madhe në kohën që u

shfaq dhe po ndikon mbi jetwn e gjithsecilit, pandemia e Covid-19, është që t'i përgjigjemi me efikasitet kësaj krize të gjithanshme, por pa cënuar vlerat dhe të drejtat njerëzore. Shkalla dhe mënyra e marrjes së masave kufizuese nga institucionet ligjore shtetërore, nuk duhet të kapërcejë kufijtë e ligjit të së drejtës. Sipas Gjykatës së Strasburgut:

“I takon në radhë të parë çdo Shteti nënshkrues, me përgjegjësinë e tij për ‘jetën e kombit [të tij]’, të vendosë nëse kjo jetë kërcënohet nga një emergjencë publike dhe, nëse është kështu, sa larg nevojitet të shkohet në përpjekjet për kapërcimin e asaj emergjence” (Council of Europe 2020).

Por duhet theksuar se Covid-19 “pati pasoja për ekonominë botërore, shëndetin publik dhe mënyrën e jetesës. Virusi solli një regjim të ri të distancimit social dhe fizik”. (OSBE 2020 )

Pandemia ka cënuar jetën dhe shëndetin e individëve, por s’duhet lejuar që të cënojë edhe liritë e të drejtat e njeriut. Përballë një armiku të padukshëm si Covid-19, shoqëria njerëzore rrezikon të kthehet në një turmë, që vetëm duhet të bindet ndaj kufizimeve që i vendosen asaj.

Po cilat janë këto kufizime? Masat janë të shumta, ndërsa dijet dhe zgjidhjet rreth pandemisë janë të pakta. Cënimi i shumë lirive dhe të drejtave justifikohet me ‘armikun e padukshëm’. Covid 19 ka kufizuar të drejtat individuale, pasi jeta e njeriut është bërë më e pasigurtë, dhe ka sjellë probleme politike globale lidhur me origjinën e pandemisë, si dhe probleme ekonomike, psikologjike dhe shumë tjera. Shtetet duhet ta kenë të qartë që çdo masë e marrë s’duhet të cënojë vlerat e demokracisë dhe shtetit të së drejtës. Prandaj vendosja e masave kufizuese në shërbim të pandemisë duhet të jetë në proporcionalitet me liritë e të drejtat e individit. Pandemia s’duhet të triumfojë mbi shtetin e së drejtës,

Kushtetutën dhe të drejtat e njeriut. Çdo masë e marrë duhet të jetë në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin e së drejtës. Kufizimet rreth pandemisë janë të nevojshme, por duhet të shihet nëse këto masa janë marrë në përputhje me legjislacionin në fuqi, të shikohen afatet por edhe ashpërsia e kufizimeve të ndërmarra.

“Para marrjes së kësaj mase, shtetet pritet të kontrollojnë nëse ekziston një bazë ligjore relevante dhe të shqyrtojnë nëse masat që çojnë në privimin e lirisë janë rreptësisht të nevojshme përkundëjt masave të tjera alternative më pak shtrënguese” (Council of Europe 2020).

Është zbehur besimi se njerëzit mund t’i kthehen shpejt normalitetit si dikur dhe kjo ka sjellë dobësimin e elementeve të një shoqërie të lirë dhe demokratike. Edhe institucionet ndërkombëtare gjithnjë e më shumë, kanë shprehur shqetësimin, se kriza e Covid-19 duhet të menaxhohet me përgjegjësi të mëdha dhe se shtetet duhet të bëjnë përpjekjet maksimale për t’iu kthyer sa më shpejt normalitetit.

“Sa më shpejt që të jetë e mundshme, për qeveritë do të jetë e rëndësishme të sigurojnë kthimin e jetës në normalitet, dhe jo të përdorin pushtetin emergjent që pafundësisht të rregullojnë jetën e përditshme, duke pranuar se reagimi duhet të përshtatet me nevojat e fazave të ndryshme të kësaj krize” (UNMIK 2020).

Pyetja thelbësore që shtrohet për diskutim është se a janë në proporcion të drejtë kufizimet e vendosura për t’u mbrojtur nga pandemia globale Covid-19, me pasojat që mund të sjellin tek liritë dhe të drejtat e njerit?

“Nganjëherë qeveritë kanë ndërmarrë masa tepër agresive dhe kundërproduktive në përballjen me sfidat e krijuara nga kjo situatë” (Instituti Shqiptar i Medias 2020).

Situata e pandemisë ka ndikuar që shtetet të vendosin gjenden e emergjencës civile ose gjendjen e jashtëzakoshme. Natyrisht gjendja e jashtëzakoshme është një masë e ndikuar nga situata e pandemisë, por edhe ajo duhet të ndërmerret në përputhje me dispozitat kushtetuese dhe ligjore, gjithashtu edhe në bashkëpunim me qytetarët.

“Gjendja e jashtëzakonshme ushtron presion shumë të madh mbi shtetin dhe shoqërinë. Për ta trajtuar atë në mënyrë të efektshme, qeveritë kanë nevojë për bashkëpunimin e qytetarëve të tyrë... Bashkësia ndërkombëtare duhet të angazhohet në mënyrë aktive për të siguruar që qeveritë -të- rivendosin rendin kushtetues në të cilin përsëri të drejtat të sigurohen në mënyrë të plotë” (DCAF 2006).

Gjithashtu pandemia solli keqinformim dhe deformim të lirisë së shprehjes, madje shqetësimi shkon deri aty sa pandemia “ka shkaktuar frikë, diskriminim dhe intolerancë në shumë vende të botës. Individë dhe komunitete që preken nga kjo valë e ‘gjuhës së urrejtjes’ kanë frikë se kjo retorikë agresive mund të përshkallëzohet në akte dhunë dhe diskriminimi” (Instituti Shqiptar i Medias 2020). Natyrisht liria e shprehjes është një e drejtë e rëndësishme, por deri në kufijtë që lejohet nga aktet kombëtare dhe ndërkombëtare juridike. Dhe kjo nuk do të thotë që kjo e drejtë të çenohet dhe të censurohet, qoftë me ligj apo me veprime të tjera jo të duhura.

Problemet që u hasën në lidhje me median ishin se: “u rrit keqinformimi dhe propaganda, por edhe censura, publiku mori informacion me vonesë



për këtë sëmundje dhe në shumë raste jo të saktë, cënimi prekte sigurinë kombëtare, rendin publik, shëndetin dhe moralin publik dhe sillte diskriminim” (Instituti Shqiptar i Medias 2020).

Media ka të drejtë që të japë informacion të saktë dhe pa u censuruar, ndërsa publiku ka të drejtë të marrë informacion të vërtetë në kohën e duhur dhe pa u cënuar liritë dhe të drejtat e njeriut. Shtetet duhet të punojnë bashkë me platformat online dhe me median për të parandaluar manipulimin e opinionit publik, si dhe për t’u kushtuar më shumë vëmendje burimeve përgjithësisht të besuara të lajmeve dhe informacioneve, sidomos atyre që komunikohen nga autoritetet e shëndetit publik (Council of Europe 2020).

A është cënuar e drejta e shëndetit? Nëse po si është cënuar ajo? Sipas nenit 12, të Konventës Ndërkombëtare të të Drejtave Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (ICESCR), “ndër të tjera i ngarkon shtetet nënshkruese me detyrën që të parandalojnë, trajtojnë dhe të mbajnë nën kontroll epidemitë” (Instituti Shqiptar i Medias 2020).

Por çfarë detyrimesh ka një shtet ndaj qytetarëve të tij, gjatë gjendjes së pandemisë? Shteti duhet të japë një informim të saktë shkencor dhe mjekësor, qytetarët duhet të kenë të drejtën të japin kontributin dhe idetë e tyre, duhet të ndalet diskriminimi, censura, propaganda, keqinformimi, si dhe shteti duhet të respektojë ligjin e së drejtës, mendimet e vendimet e institucioneve shëndetësore, për të mbrojtur shëndetin e qytetarëve.

A është cënuar liria e lëvizjes gjatë periudhës së pandemisë? Sipas Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut:

“Shtetet kanë detyrimin për të bërë një vlerësim të kujdesshëm të ndërhyrjes së tyre tek të drejtat dhe liritë e atyre brenda juridiksionit të tyre, dhe për të kufizuar impaktin e tyre mbi këto

të drejta vetëm deri në atë shkallë, dhe vetëm për aq kohë sa kërkohet nga urgjencat e pandemisë” (CRD 2020).

Kufizimet e lëvizjes janë të ndikuara nga pandemia por këto kufizime nuk duhet të çënojnë thelbin e të drejtës së lëvizjes. Pra këto kufizime duhet të jenë të mirëpërcaktuara, të arsyeshme, dhe në afatet e duhura kohore.

Si ka ndikuar Covid-19 tek shteti i së drejtës? Pandemia e Covid-19, si në të gjitha fushat ka pasur ndikim edhe tek ligji dhe shteti i së drejtës. Institucionet e shumë shteteve janë zënë në befasi nga ndikimi dhe pasojat e shumta të shkaktuara nga pandemia e fundit globale Covid-19:

“Në Shqipëri, situata e shtetit të së drejtës shfaqet problematike, megjithatë ka prirje për përmirësim në fushat e gjyqësorit, korrupsionit dhe të drejtave të njeriut...” (Endri Mykaj, 2020).

Në shumë vende të botës, edhe tek të drejtat e personave në institucionet e paraburgimit dhe të burgjeve, janë shfaqur probleme. Edhe në Shqipëri, sipas OSBE-së:

“Mbyllja në burgje ndikoi te puna e këshilluesëve ligjorë, vizitat e të cilëve në burgje u pezulluan *de facto*. Edhe vizitat e familjarëve dhe veprimtaritë jashtë qelive u pezulluan... Në bazë të gjetjeve të mësipërme, raporti jep rekomandime për ndërhyrje afatshkurtra dhe afatmesme, në lidhje me trajtimin e të burgosurve dhe të paraburgosurve, në përputhje me parimet dhe standardet e pranuar ndërkombëtarisht” (OSBE 2020 ).

Shteti gjithashtu e ka për detyrim të sigurohet që ata që janë të privuar nga liria, përfshirë ata që janë në burg, në qendra paraburgimi, në spitale psikiatrike dhe qendra të kujdesit social, të kenë ndihmën mjekësore të

duhur, në mënyrë që të sigurohet shëndeti dhe mirëqenia e personave. (CRD 2020)

Për tejkalimin e masave shtërnguese në kohën e pandemisë është shprehur edhe Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Kjo Gjykatë e vendit fqinjë me popullsi me shumicë shqiptare, ka gjykuar nëse masat shtërnguese janë në proporcion me kufizimin e të drejtave të njeriut, duke theksuar se:

Qeveria ka vepruar përtej autorizimit të dhënë me pikat b) të nenit 41 të Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjytëse, duke ndaluar qarkullimin e të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës në të gjithë territorin e saj” (Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit nr. 01/15 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, 2020).

Në këtë rast është me rëndësi të përmendim se në Kosovë edhe në kohën e pandemisë, institucionet gjyqësore vazhdojnë të mbrojnë liritë e të drejtat e njeriut, nëpërmjet vendimeve të tyre gjyqësore kushtetuese e ligjore.

Parimi i nevojës kërkon që masat e emergjencës të jenë në gjendje të arrijnë qëllimin e tyre me ndryshime minimale të rregullave dhe procedurave normale të vendimmarrjes demokratike (Council of Europe 2020).

## **2. Jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut, lidhur me ndikimin e Covid-19 tek të drejtat e njeriut**

Më poshtë, po paraqesim disa interpretime nga jurisprudenca gjyqësore e Gjykatës së Strasburgut, ku trajtohet nëse kufizimet e ndërmara gjatë periudhës së pandemisë, a janë të justifikuara dhe në përputhje me liritë e të drejtat e njeriut. Gjykata e Strasburgut ka pranuar kufizimet që kanë

bërë shtetet të diktuar nga kushtet e pandemisë, por deri në atë masë sa këto kufizime nuk shkelin thelbin e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut.

Lidhur me të drejtën e shëndetit dhe të jetës, Gjykata e Strasburgut është shprehur:

“Në kuadër të përpjekjeve për të maksimizuar qasjen në trajtim jetëshpëtues për Covid-19, dhe për të shtuar kapacitetet e punonjësve mjekësorë dhe të tjerëve për të reaguar ndaj rritjes së numrit të pacientëve me Covid-19, Shtetet i kanë mbyllur shërbimet mjekësore që gjykohen si jo-esenciale dhe kanë shtyrë vizitat e planifikuara për semundje të tjera” (CRD 2020).

Distancimi social dhe karantina kanë shtuar problemet nga më të ndryshmet tek qytetarët. Sipas Gjykatës së Strasburgut:

“Janë duke u shtuar shqetësimet për shtimin e ideve për të lënduar veten ose për të bërë vetëvrasje gjatë pandemisë për shkak të faktorëve të tjerë si frika, izolimi, distancimi fizik, reduktimi i shërbimeve mbështetëse, humbja e të ardhurave, mbyllja e bizneseve, dhe ekspozimi i madh i të infektuarve me Covid-19 ndaj punonjësve në vijën e parë të frontit” (CRD 2020).

Duhet theksuar se kufizimet e tepërta mund të çojnë në cënimin e vlerave njerëzore:

“Kufizimet e konsiderueshme të aktiviteteve të zakonshme sociale, duke përfshirë aksesin në vendet publike të adhurimit, organizimet publike dhe ceremonitë e martesave apo funeraleve, mund të çojnë në mënyrë të pashmangshme në ankesa të argumentuara...” (Council of Europe 2020).

Lidhur me lirinë e shprehjes, Gjykata e Strasburgut iu vë në dukje shteteve se duhet të jenë më përgjegjëse dhe se duhet ta fitojnë besimin tek publiku. Sipas saj shtetet: “janë përgjegjëse për reagimin në situata krize dhe duhet ta fitojnë vetë besimin publik, pa u mbështetur tek kufizimet e shprehjes për ta arritur këtë” (CRD 2020). Madje sipas Gjykatës së Strasburgut, nuk është e lejueshme të shkelen liritë dhe të drejtat e njeriut, edhe në situatat e krizave dhe të emergjencave.

### **1. Problemet e gjyqësorit në Shqipëri gjatë periudhës së Covid-19**

Sistemi gjyqësor, është një ndër hallkat kryesore të shtetit të së drejtës, dhe luan rol madhor në mbrojtjen e vlerave demokratike. Kushtetuta, normat kombëtare dhe ndërkombëtare i kanë dhënë rëndësi të veçantë mbrojtjes së të drejtave të njeriut nga sistemi i drejtësisë. Përveç ndarjes së pushteteve dhe pavarësisë së gjyqësorit, e rëndësishme është edhe dhënia e drejtësisë.

Sipas nenit 17 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, vetëm me ligj mund të bëhet kufizimi i të drejtave e lirive të njeriut, dhe duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka shkaktuar këtë kufizim. Këto kufizime nuk mund të tejkalojnë kufizimet e vendosura nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, lidhur me liritë dhe të drejtat e njeriut. Gjithsesi, një interpretim përfundimtar në lidhje me çënimet e mësipërme, e jep vetëm Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë.

Në periudhën e pandemisë, është e rëndësishme që të mos çënohen të drejtat e qytetarëve në proceset gjyqësore. Individët duhet të kenë mundësinë për t’u ankuar në gjykatë, për të gjitha shkeljet ligjore e kushtetuese që ata pretendojnë. Vonesat e shërbimeve gjyqësore,

tregojnë për mangësi të lirive e të drejtave të njeriut, por dhe të shtetit të së drejtës. Gjithkujt duhet t'i jepet e drejta për të shkuar në gjykatë dhe për të marrë të drejtat, që i takojnë.

Funksioni themelor i gjyqësorit, veçanërisht Gjykatat Kushtetuese, në rastet kur ato ekzistojnë, duhet të vazhdojë të ruhet. Është e rëndësishme që gjyqtarët të mund të shqyrtojnë kufizimet më të rënda të të drejtave të njeriut që vendosen nga legjislacionet e miratuara në raste emergjence.<sup>69</sup> Gjykata shqyrton nëse këto kufizime kanë sjellë diskriminim për individët, dhe nëpërmjet vendimeve të tyre, arrijnë të vendosin ligjin e së drejtës dhe liritë e të drejtat e njeriut.

Një nga problemet më të mprehta për gjyqësorin, është se covid-19, ka shtuar shtyrjen e afateve për gjykimet e çështjeve gjyqësore, dhe kjo ndikon në kufizimin e cënimit e të drejtave të njeriut. Institucionet shtetërore e gjyqësore kanë detyrim të ruajnë jetën e punonjësve të drejtësisë, por gjithashtu edhe të japet drejtësia. E drejta e një gjykimi të shpejtë dhe të drejtë, si një e drejtë e çdo individ që pretendon që i janë shkelur të drejtat, dhe shkon në gjykatë për të vënë në vend drejtësinë, nuk duhet të kufizohet e cënohet, sepse kjo bie në kundërshtim me aktet kombëtare e ndërkombëtare juridike, dhe me vetë thelbin e lirive e të drejtave të njeriut. Por nëse në gjykata nuk gjendet kjo mundësi, shkelja e lirive e të drejtave të njeriut thellohet më tej.

Çdokush kishte dhe ka të drejtë për të marrë drejtësi, brenda rregullave për mbrojtjen nga Covid-19, por dhe normave kombëtare e ndërkombëtare të së drejtës.

### **PËRFUNDIME**

Mbrojtja e lirive dhe të drejtave të njeriut, duhet të bëhet pa shkelur të drejtat shëndetësore të individëve dhe vetë të drejtat e njeriut, përveç të tjerave, kanë si qëllim edhe mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të individit.

Pyetjes se a u prekën të drejtat dhe liritë e njeriut në Shqipëri prej shpalljes së pandemisë dhe ecurisë së saj deri në mes të muajit qershor, do t'i përgjigjemi me ligjet që e sqarojnë mirë e saktë këtë. Metodologjia cilësore ka ndihmuar që përmes saj të sqarohen të gjitha ato që u takojnë individëve edhe në kushte të tilla të jashtëzakonshme.

Të drejtat e njeriut nuk mund të tjetërsohen ose të hiqen edhe në gjendjen e pandemive globale, por ato mund të kufizohen pa çenuar thelbin dhe rëndësinë e tyre.

Edhe në gjendjen e pandemisë, shteti mund të ndërhyjë vetëm në proporcion me liritë e të drejtat e njeriut, duke respektuar të gjitha parimet ligjore, kushtetuese, e ndërkombëtare. Pra institucionet shtetërore mund të veprojnë deri në masën e kërkuar nga urgjenca e shkaktuar nga pandemia, por dhe deri në masën e lejuar nga të drejtat dhe liritë e individit.

**BIBLIOGRAFI**

Council of Europe. (2020). *Respektimi i demokracisë, shtetit të së drejtës dhe të drejtave të njeriut në kuadrin e krizës sanitare të COVID-19*. Dokument Informativ, Council of Europe.

CRD. (2020). *Covid-19 dhe Impakti mbi të Drejtat e Njeriut, Shikim i përgjithshëm mbi jurisprudencën përkatëse Shikim i përgjithshëm mbi jurisprudencën përkatëse*. Tiranë: AIRE Centre.

DCAF. (2006). *Gjendjet e emergjencës*. Informativ, DCAF.

Endri Mykaj. (2020). *VLERËSIM I SITUATËS SË SHETIT TË SË DREJTËS NË SHQIPËRI*. Informativ, Tiranë: Civil Rights Defenders.

Instituti Shqiptar i Medias. (2020). *Media dhe Koronavirusi, Udhëzime për gazetarët që raportojnë pandeminë*. Udhëzim, Tiranë: Instituti Shqiptar i Medias.

OSBE. (2020). *TË DREJTAT E NJERIUT NË MJEDISËT E PRIVIMIT TË LIRISË PËRGJATË PANDEMISË COVID-19, RASTI I SHQIPËRISË*. Tiranë: OSBE.

Simoni, Zef. (2001). *Fjalori Politik i Oksfordit, 1996*. Tiranë: Shtëpia e Librit & Komunikimit.

UNMIK. 2020. *TË DREJTAT E NJERIUT NË ZEMËR TË PËRGJIGJES, UDHËZUESI COVID-19*. Raport Informues, Prishtinë: UNMIK.

*Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit nr. 01/15 të Qeverisë së Republikës së Kosovës*. (2020). KO54/20 (Gjykata Kushtetuese e Kosovës, 6 prill).



**Sonila CAMI<sup>70</sup>**

## **Role of Pre-university Curriculum and Respective Legislation over some Important Phases of Child Development**

### **Abstract**

The analysis of specific aspects of children education from the psychological, medical, sociological and pedagogical perspectives is a well known and tangible practice.

Sometimes, the role of legislation is not included in the discussions of above-mentioned factors dealing with the principles of raising and educating the children. The law has an absolute impact in the implementation of the principles and the implementation of the structures that apply the principles. The development of the appropriate habits of children in order for them to restrict as much as possible their usage of technological devices and internet is a matter that should overpass the frames of the educational treatment alone. It should be handled also within the framework of the legislation on the schooling stages of pre-university education, more precisely in its curriculum.

Taking into consideration the enormous risk of the dependence from the technological devices, as well as the relation between such increasing

---

<sup>70</sup> Sonila CAMI,  
Doktorante pranë Fakultetit të Drejtësisë,  
Departamenti i së Drejtës Civile,  
Universiteti i Tiranës  
[sonila.cami@yahoo.com](mailto:sonila.cami@yahoo.com)

danger and the efforts to prevent and halt this risk, there arises the need to search and find new ways that help in detoxicating from the dependence on technological devices, which are so widely used by children. The implementation of a serious curriculum since early childhood will ensure that the discussion on the harms of excessive use of technological devices will be done also through the obligatory education. The discussion will be performed in the presence of children and with their participation, in the hope that the energy and concentration of children will be focused on more useful areas for them.

**Key words:** *Scholastic curriculum and legislation on pre-university education, child, dependence from usage of technology, school*

## 1. Hyrje.

Edukimi i fëmijës, përgjithësisht shihet si sfidë prindërore, sfidë e edukatorëve të të gjitha niveleve, sfidë e shoqërisë. Dhe, veçanërisht në botën e sotme të internetit dhe teknologjisë, të gjithëpërfshirjes dhe njëkohësisht të izolimit shoqëror, edukimi i fëmijëve është një sfidë. Si e tillë, përballja me të, kërkon mjete të sofistikuara, siç është në vetvete e sofistikuuar rritja e fëmijës si proces, dhe siç janë të sofistikuara edhe rreziqet me të cilat përballlet fëmija.

Në mënyrë të natyrshme, prindërit dhe mësuesit, janë përpjekur në vite të ballafaqohen me ndryshimin, edhe pse ndryshimi vjen në ritme shumë më të shpejta se sa qasja e brezave ndaj tij.

Në mënyrë të institucionalizuar, brenda mureve të shkollës, kërkohet të edukojmë një brez të ri të formuar më së miri.

A trajtohen lëndët e formimit të përgjithshëm edukativ, me të njëjtën rëndësi, a vendosen në të njëjtin pozicion të rëndësishëm në kurrikulat e arsimit parauniversitar, me lëndët e tjera të shikuara tradicionalisht si bazë e programeve mësimore parauniversitare?

A duhet të jenë vetëm këshilla standarte për prindërit dhe edukatorët, informimi dhe përpjekja për të mbrojtur dhe parandaluar nga rreziku i përdorimit të mjeteve të teknologjisë dhe internetit?

Ligji dhe aktet në funksion të tij, i detyrueshëm siç është në karakterin e tij, është i aftë të sigurojë hapësirën e duhur për të parandaluar fenomene sociale me dëme afatshkurtra dhe afatgjata, pikërisht duke synuar në zemër të çështjes, në edukimin, në mësimdhënien dhe mësimnxënien,

me anë të impaktit të drejtpërdrejtë të nxënies drejt përfimit të shprehive.

Në atë organizëm, që në vija të përgjithshme e quajmë shkollë, duhet të mund të parashikojmë strukturimin e kurrikulave, si një kornizë dijeje gjithëpërfshirëse me synim parandalimin, mënjanimin dhe braktisjen e çdo praktike të dëmshme në përditshmërinë e fëmijës sot, sa i takon fenomenit të përdorimit të tepruar të mjeteve të teknologjisë dhe internetit.

## **2. "Toxic childhood"<sup>71</sup> - Fëmijëri e helmuar.**

Sindroma e fëmijës së toksikuar, është një terminologji e përdorur në librin "Toxic childhood" të Sue Palmer. Tematika e librit, trajton gjerësisht fenomenin e përdorimit të mjeteve të teknologjisë dhe internetit, ndikimin në jetën e fëmijës. Nën kërkimin e mirëfilltë mbi fëmijën toksik në shumë aspekte të varësive që mund të ndërtojnë fëmijët sot, libri i jashtëzakonshëm në llojin e tij, jep një panoramë të gjerë mbi çështjet që trajton, si këshilla e sugjerime mbi detoksimin e fëmijës. Një nga pikat më shpresëdhënëse për kërkuesen dhe autoren Palmer, kanë qenë pikërisht prindërit dhe edukatorët që ka takuar, si rezultat i këtij libri.<sup>72</sup>

### **2.1. Disa statistika aspak frymëzuese**

---

<sup>71</sup> Palmer Sue, (2007) Toxic Childhood. How the modern world is damaging our children and what we can do about it?

<sup>72</sup> Palmer Sue, (2006) Toxic Childhood. How the modern world is damaging our children and what we can do about it? Preface.

“Tronditje” është fjala më e duhur tek e cila më shkon mendja, për të përshkruar reagimin tim kur lexova rezultatet e fundit të Kaiser Foundation survey mbi përdorimin e teknologjisë nga të rinjtë 8 deri 18 vjec. Studimi i vitit 2009 ishte vijimësia e një studimi të njëjtë, të zhvilluar në vitin 2005. Në studimin e mëparshëm, kërkuesit zbuluan që mesatarisht, të rinjtë shpenzonin më shumë se 5 orë e gjysëm në ditë, duke u marrë me teknologji pa pasur lidhje me shkollën. Në atë kohë, ata e morën të mirëqenë faktin se në sajë të programeve të ngjeshura që të rinjtë kanë ditët e sotme, një rritje në përdorimin e teknologjisë, do të ishte e pamundur. Por sa gabim e menduan ata! Studimi i dytë, nxorri në dukje se në 2009 e njëjta grup-moshe shpenzonte më shumë se 7 orë e gjysëm në ditë në teknologji pa pasur lidhje me shkollën. Kjo është një rritje prej më shumë se 1/3 në vetëm 4 vjet!<sup>73</sup>

Duke folur për aftësi për jetën, sipas një studimi nga AVG, shoqëria për sigurinë në internet, zbuloi se fëmijët përvetësojnë më shumë aftësi teknike se jetësore. Për shembull, ndërsa 58% e grupit 2 deri 5 vjeç, mund të luajnë një lojë në kompjuter, vetëm 43% mund të ngasin një biçikletë. Në të njëjtin grup-moshë, 10 % mund të përdorë një aplikacion smartphone, ndërsa vetëm 9% mund të lidhin këpucët e tyre. Dhe një statistikë e frikshme: më shumë fëmijë mund të hapin një web browser sesa mund të notojnë.<sup>74</sup>

---

<sup>73</sup> Jim Taylor, PhD. Children’s Immersion in Technology is “Shocking” Do you know how much technology your children are using?  
<https://www.psychologytoday.com/blog/the-power-prime/201209/children-s-immersion-in-technology-is-shocking>

<sup>74</sup> Jim Taylor, PhD. Children’s Immersion in Technology is “Shocking” Do you know how much technology your children are using?  
<https://www.psychologytoday.com/blog/the-power-prime/201209/children-s-immersion-in-technology-is-shocking>

Statistika të kësaj natyre me fakte “shokuese”, duket se kërkojnë larmi strategjish. Arritja e një zgjidhjeje, dikton bashkëpunimin e shumë sistemeve ndërvepruese. Më sipër është vetëm një ilustrim statistikor në kushte ‘normale’, të përdorimit të teknologjisë. Ende, në kushtet, në të cilat shkolla ishte ende një vendtakim fizik dhe jo seanca e radhës së ‘takimit’ me internetin. Megjithatë përpjekjet duhet të vazhdojnë. Përditësimi dhe vlerësimi i mundësive konkrete nuk mund të ndëpriten, shkolla është dhe duhet të mbetet fronti i reflektimit dhe përshtetjes së asaj që duhet të jetë dhe mund të jetë edukimi dhe arsimit në interesin më të lartë të fëmijës.

Sot dhe nesër, del një nevojë e shtuar e përdorimit dhe vetëkufizimit të njëkohshëm, të mjeteve të teknologjisë, si dhe sfida e gjetjes së mundësive që kjo ‘e vërtetë’ të arrijë dhe përthithet nga fëmijët.

### **3. Fragmente nga të drejtat e fëmijëve në përgjithësi dhe baza ligjore ekzistuese mbi arsimin parauniversitar**

Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, shpalli më 20 nëntor, 1959 "Deklaratën për të Drejtat e Fëmijës". Në hyrjen e deklaratës në fjalë thuhet: Njerëzimi, u ka borxh fëmijëve gjërat më të mira që ai mund t’u ofrojë.<sup>75</sup> Një sfidë e rëndësishme, në jetën e fëmijëve sot, për t’u përballur si edhe për të administruar pasojat individuale apo në bashkësi, duket se është aktiviteti dhe lidhja e fëmijëve me botën e teknologjisë. Rrisitë, ndryshimet, dobitë e teknologjisë, përdorimit të internetit e të tjerë, nuk janë subjekt i këtij artikulli, por është subjekt i kësaj teme, hulumtimi mbi gjetjen e

---

<sup>75</sup>[http://www.dados.org/alb/menschenrechte/Grundkurs\\_MR3/Kinderrechte/kinderre.htm](http://www.dados.org/alb/menschenrechte/Grundkurs_MR3/Kinderrechte/kinderre.htm)

ndërtimin e çdo mënyre efikase për parandalimin dhe restaurimin e dëmeve të përdorimit të tepruar të mjeteve të teknologjisë dhe internetit, siç parashikon edhe Deklarata më sipër *si një borxh*, që u kemi fëmijëve të gjeneratës së teknologjisë.

Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës, (e pranuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB më 11 dhjetor 1989)<sup>76</sup> në nenin 28 të saj bën fjalë për edukimin dhe arsimimin:

Çdo fëmijë ka të drejtë për arsimim, dhe është detyrë e shtetit të bëjë të detyrueshëm ndjekjen pa pagesë të arsimit fillor, të zhvillojë forma të ndryshme të arsimit të mesëm, si dhe t'u sigurojë fëmijëve, në varësi të aftësive të tyre përkatëse vazhdimin e shkollave të larta.

Neni 29 përcakton sipas Konventës qëllimet e arsimimit:

Arsimimi ndihmon shpалosjen e personalitetit, talenteve, si dhe të aftësive shpirtërore dhe fizike të fëmijës. Arsimimi e për gatit fëmijën për rrugën e jetës me vetëdije për përgjegjësi si qytetar në një shoqëri të lirë dhe nxit respektin e fëmijës ndaj prindërve të tij, identitetit të tij kulturor, por edhe për tolerancë dhe mirëkuptim për botëkuptimet e të tjerëve.<sup>77</sup>

---

<sup>76</sup>[http://www.dadalos.org/alb/menschenrechte/Grundkurs\\_MR3/Kinderrechte/dokumente/dokument2.htm](http://www.dadalos.org/alb/menschenrechte/Grundkurs_MR3/Kinderrechte/dokumente/dokument2.htm)

<sup>77</sup> Konventa për të drejtat e fëmijës. Miratuar dhe hapur për nënshkrim, për ratifikim dhe për aderim nga Asambleja e Përgjithshme me Rezolutën e saj 44/25 të datës 20 nëntor 1989. Hyri në fuqi 2 shtator 1990, në përputhje me nenin 49. <http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/Ahri/AConRightsChild.pdf>

### 3.1. Disa përkufizime mbi arsimin parauniversitar në Shqipëri

Neni 2, pika 1 e ligjit Nr. 69/2012, (i ndryshuar me ligjin nr. 56/2015 dhe ligjin nr. 48/2018, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”<sup>78</sup>, përcakton si më poshtë:

“Arsimi parauniversitar” përfshin nivelet arsimore me kodet 0, 1, 2 dhe 3, sipas “Klasifikimit Ndërkombëtar Standard të Arsimit”, të miratuar nga Konferenca e Përgjithshme e UNESCO-s, në sesionin e 29-të të saj, në nëntor 1997, përkatësisht:

- a) “Niveli me kodin 0”, arsimi parashkollor;
- b) “Niveli me kodin 1”, arsimi fillor;
- c) “Niveli me kodin 2”, arsimi i mesëm i ulët;
- ç) “Niveli me kodin 3”, arsimi i mesëm i lartë.

Përgjatë arsimimit në sistemin parauniversitar, synohet në vija të përgjithshme që fëmija të zhvillohet në aspektin etik, intelektual, fizik, social dhe estetik, të jetë i aftë të mendojë në mënyrë të pavarur, kritike e krijuese, t’u përshtatet ndryshimeve, të ketë vetëbesim e shpirt bashkëpunimi, të jetë i gatshëm të ofrojë ndihmesën e tij për mirëqenien, përparimin, lirinë e demokracinë.

Konkretisht, mbi qëllimin e arsimit parauniversitar bën fjalë neni 3 i Ligjit për Arsimin Parauniversitar, me ndryshimet (më poshtë ligji).

---

<sup>78</sup> Ky ligj është përafëruar plotësisht me: Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Europian (2000/C 364/01), datë 18 dhjetor 2000, Numri CELEX 32000X1218(01) Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria C, Nr 364, datë 18.12.2000, faqe 1-22.



Sistemi arsimor parauniversitar ka për qëllim formimin e çdo individi, në mënyrë që të përballojë sfidat e së ardhmes, të jetë i përgjegjshëm për familjen, shoqërinë e kombin dhe në mënyrë të veçantë : krijimin e kushteve dhe mundësive që nxënësit të ndërtojnë dhe të zhvillojnë njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera; të zhvillohen në mënyrë të pavarur e të gjithanshme;

Në arsimin parauniversitar nxënësit kultivojnë identitetin vetjak kombëtar dhe përkatësinë kulturore; përvetësojnë vlera të përgjithshme kulturore dhe qytetare; zhvillohen në aspektet intelektuale, etike, fizike, sociale dhe estetike; zhvillojnë përgjegjësi ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit; aftësohen për jetë dhe për punë, në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore; aftësohen për të nxënë gjatë gjithë jetës; zhvillojnë shpirtin e sipërmarrjes; përdorin teknologjitë e reja.

Ndërsa neni 22, pika 1 e këtij ligji bën fjalë për arsimin bazë :

Arsimi bazë synon zhvillimin shoqëror, intelektual e fizik, të çdo nxënësi, zotërimin e rregullave të sjelljes dhe kultivimin e vlerave, përkujdesjen për shëndetin, si dhe përgatitjen e mjaftueshme për vazhdimin e arsimit të mesëm të lartë ose për tregun e punës. Siç edhe shihet nga kuptimet që sjell ligji, detoksimi i fëmijës nga përdorimi i tepruar i mjeteve të teknologjisë, përkon me kërkesat dhe qëllimet bazë mbi përkujdesjen për shëndetin, që vetë ligji synon të përmbushë.

### **3.2. Në brendësi të angazhimeve të arsimit parauniversitar, si faktor ndihmues në formimin e fëmijës**

Gjithmonë në dritën e legjislacionit përkatës, konkretisht atij të lartcituuar, mbi arsimin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, në nenin 2, përcaktohet si më poshtë: “Fushë e të nxënësve” është një lëndë ose bashkësi lëndësh që shqyrtojnë realitetin nga këndvështrime të caktuara.

“Kurrikula” është sistemi i përbërë nga disa elemente, si: korniza kurrikulare, kurrikula bërthamë, programet mësimore, vlerësimi, që të lidhura mes tyre, lejojnë të orientohet dhe të funksionojë sistemi arsimor, nëpërmjet planeve arsimore dhe administrative. Kurrikula siguron arsimim cilësor dhe të barabartë për çdo pjesëtar të shoqërisë, pavarësisht nga përkatësia etnike, seksi, pozita shoqërore.

“Korniza kurrikulare” është dokumenti themelor i kurrikulës, ku përshkruhen synimet e përgjithshme të saj, kompetencat themelore, rezultatet e pritshme për nxënësit, për sa i përket dijeve, aftësive dhe qëndrimeve në fund të arsimit bazë dhe atij të mesëm të lartë, synimet e fushave të të nxënësve dhe parimet e përgjithshme të procesit të mësimdhënies e nxënies e të vlerësimit të nxënësve.

“Kompetenca themelore” është kompetenca, për të cilat kanë nevojë të gjithë individët për plotësim dhe zhvillim vetjak, për qytetari aktive, për përfshirje shoqërore dhe për punësim.

Këto janë disa nga përcaktimet e ligjit. Kjo, për të treguar se koncepte të tilla “mbrohen” dhe garantohen me ligj. Po më tej?

A mund të modifikohet, të përsoset çdo vit e në vijim, kjo fushë e të nxëniet? Konkretisht, cilat janë lëndët që i duhen një fëmije që nga fazat më të hershme të zhvillimit të tij në kuadrin e arsimit parauniversitar, në mënyrë që dija, të nxënurit, ndërgjegjësimi, formësimi të kanalizohet në interesin më të mirë të fëmijës, duke u përditësuar me çdo risi që bën vend në jetën e fëmijës, për t'i përthithur të rejtat, dhe për t'i bërë ballë pasojave negative të çdo risie? Lëndët në programet mësimore, përgjithësisht janë konceptuar si deduksion i eksperiencave shumëvjeçare në fushën e nxënies. Tradita, historiku na sjell gjithmonë lëndë si “matematika”, “gjuha e huaj” e të tjerë. Në vijim të ndryshimeve, tradita duhet të pasurohet në mënyrë të qartë, me lëndë të detyrueshme që paralajmërojnë, orientojnë, konfigurojnë rreziqet nga teprimi me mjetet e teknologjisë dhe mundësitë e shpenzimit të kohës tej kufijve "teknologjikë".

Në fazat të ndryshme të zhvillimit, fëmija përvetëson koncepte, mëson mbi atë që duhet të dijë, pikërisht nga ajo çfarë i ofrohet.

Në mënyrë të qartë, legjislatori në zbatim të të gjithë kornizës ligjore përkatëse, duhet të orientojë përmbajtjen e teksteve, lëndët, kurrikulën në përgjithësi, drejt pasurimit të dijes dhe vetëdijes së fëmijës për atë që është e dobishme, shumë e dobishme, apo e dëmshme për të, në interesin më të mirë për nxënësin.

Siç parashikon edhe Ligji në nenin 6, pika 1: Në veprimtaritë e institucioneve të sistemit arsimor parauniversitar, *interesi i nxënësit është parësor*.

#### 4. Kurrikulat

Ligji ne kreun VII “Kurrikula”, përcakton në nenin 44 parimet e përgjithshme, si më poshtë:

Kurrikula zhvillohet si një e tërë për të gjitha nivelet arsimore, për sa i përket formimit të vlerave, aftësive e koncepteve kryesore, si dhe parimeve të mësimdhënies, të të nxënimit dhe të vlerësimit të nxënësve.

Kurrikula është në përputhje me ecurinë e zhvillimit fizik, mendor, shoqëror, etik të nxënësve dhe veçoritë e tyre individuale të të nxënimit.

Kurrikula hartohet dhe zbatohet në bazë të kompetencave themelore të nxënësve. Del sërish në pah togfjalëshi *kompetenca themelore e nxënësve*. Edhe përkufizimi për to na vjen drejtpërsëdrejti nga vetë ligji në nenin 13 të tij.

Kompetencat themelore për të gjithë nxënësit janë: kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit; kompetenca e të menduarit; kompetenca e të mësuarit për të nxënë; kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin; kompetenca personale; kompetenca qytetare; kompetenca digjitale.

Padyshim, secila prej tyre mund të përvijëzohet, konkretizohet, shpërndahet në formën e duhur, në formatin e duhur që të mbërrijë tek fëmija në mënyrë të natyrshme, por edhe të pashmangshme njëkohësisht, nëpërmjet arsimit. Thjesht dhe sepse, interesi më i mirë për nxënësin, është të mësuarit mjaftueshëm në shkollë për:

- Të dëmshmen, të gabuarën, të tepruarën dhe të padobishmen.

Për shkak të impaktit të jashtëzakonshëm, vendit të madh që zë përdorimi i mjeteve të teknologjisë në jetën e fëmijës, përmbajtja në tekstet e arsimit parauniversitar, duhet të orientohet drejt modelit të një lënde të re, e cila të vlerësohet me intensitet e përkushtim të njëjtë me atë që iu kushtohet lëndëve si matematika.

Lidhur me këtë, të gjithë aktorët (edukatorë të shtëpisë apo të shkollës), duhet të japin kontribut në përfitim e teksteve shkollore efikase.

#### **4.1. Kurrikulat dhe përmbajtja e tyre, mjete i lënë mënjanë sa i takon ndërgjegjësimin të vetë fëmijëve**

Paradigma e re kurrikulare bazohet në konceptet e mëposhtme :

Filozofia arsimore është një sistem opinionesh për përparësitë aktuale dhe sfidat e së ardhmes, ajo i referohet gjithashtu një tërësie kërkesash për sigurimin e cilësisë së re arsimore. Ky këndvështrim na lejon të përcaktojmë misionin e së ardhmes. Kurrikula përcakton se çfarë nxënësit duhet të dinë dhe të jenë të aftë të bëjnë, si angazhohen ndaj përmbajtjes, si është të mësuarit e tyre, si matet ai (vlerësimi) dhe si është organizuar sistemi arsimor (konteksti). Të gjitha këto hapësira i adresohen procesit të zhvillimit të kurrikulës së një vendi, rajoni apo shkolle.<sup>79</sup>

Por çfarë mund të arrihet nëpërmjet kurrikulave?

- Çdo synim afatshkurtër dhe afatgjatë, çdo orientim që studimet shkencore e çmojnë si të vlefshëm.

---

<sup>79</sup> Noti, Kozeta (2013) Kurrikula dhe aplikimi në tekstet shkollore sipas modeleve bashkëkohore, fq 3. Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave sociale, Departamenti i Pedagogjisë dhe i psikologjisë.

Me bindjen se përvetësimet e marra përgjatë zhvillimit të niveleve të arsimit parauniversitar, lënë gjurmë dhe ndikojnë në jetën e fëmijës, hartimi i teksteve shkollore duhet të pasqyrojë dhe të përfshijë nevojat e sfidat që paraqiten. Angazhimet dhe sugjerimet, duhet të jenë gjithëpërfshirëse dhe të vijnë nga çdo palë e interesuar.

Në Itali, është ngritur tashmë i ashtuquajtur "Observatori mbi cilësinë e librit shkollore", një ent ky i shoqërisë civile që përfshin një sërë shoqatash. Në fund të çdo viti publikohet një listë e teksteve shkollore të vjetër e të rinj, duke ofruar të dhëna mbi karakteristikat e tyre, veçantitë didaktike, mbi efikasitetin, mbi aftësinë e nxitjes së mendimit të lirë. Në këtë rrugëtim, i rëndësishëm është edhe roli i shoqatave të prindërve me qëllim përputhjen e tyre me kërkesat dhe objektivat e familjarëve.<sup>80</sup>

#### **4.2. Kurrikulat dhe miratimi i implementimit të teksteve të detajuara dhe të zgjeruara mbi keqpërdorimin e mjeteve të teknologjisë dhe internetit**

Legjislacioni me anë të kurrikulave mund të përpiqet t'u flasë fëmijëve dhe jo vetëm të rriturve. Si mundet legjislacioni "t'u flasë fëmijëve ? »

Paradigma e re kurrikulare nuk ka parashikuar zëvendësimin e kurrikulës ekzistuese me një kurrikul të re, por ta ridimensionojë, ta modifikojë, ta rimodelojë. E rëndësishme ka qenë që ky ridimensionim të jetë në përputhje me vizionin arsimor që nuk ka qenë një përcaktim

---

<sup>80</sup> Noti, Kozeta (2013) Kurikula dhe aplikimi në tekstet shkollore sipas modeleve bashkëkohore, fq 31. Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave sociale, Departamenti i Pedagogjisë dhe i psikologjisë.

rastësor, por i bazuar në vizionin e zhvillimit të vendit. Qëllimi i paradigmës së re është që të ndikojë që të gjithë nxënësit të funksionojnë në mënyrë optimale në shoqërinë e së tashmes dhe të së ardhmes. Ajo mban parasysh dinamikën e realitetit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar dhe të njerëzve në veprim.<sup>81</sup> Edukimi për prindërit është një refren tashmë, atyre iu thuhet e shkruhet përditë ‘të mbajnë larg fëmijët nga interneti...etj’’. Një rutinë, e vlefshme patjetër, por i tillë duhet të jetë edhe ndikimi i drejtpërdrejtë tek fëmijët. Edukimi i tyre përmes arsimit në të përvetësuarit e reflekseve në shmangien e teprive në përdorimin e teknologjisë, duhet të jetë një synim. Krahas lëndës së kompjuterit, duhet të vijë një lëndë e mirëpërdorimit të tij, e kufizimit të këtij përdorimi. Sërish, implementimi në praktikë, i teksteve të detajuara dhe të zgjeruara mbi keqpërdorimin e mjeteve të teknologjisë dhe internetit, mundëson që fëmija të ndërgjegjësohet në mënyrë institucionale dhe periodike mbi këtë keqpërdorim, gjithmonë për mirëqenien e tij personale.

## 5. PËRFUNDIM

Parë në dritën e sa më sipër, kurrikulat mësimore në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar duhet të jenë të hartuara në përputhje me risitë dhe aspektet që më së shumti afektojnë sferën e zhvillimit të fëmijës, dhe gjithmonë në përputhje me interesin më të lartë të tij.

---

<sup>81</sup> Noti, Kozeta (2013) Kurikula dhe aplikimi në tekstet shkollore sipas modeleve bashkëkohore, fq 2. Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave sociale, Departamenti i Pedagogjisë dhe i psikologjisë.

Legjislacioni përkatës duhet të mirëpërcaktojë direktiva, të implementojë lëndë, të orientojë politika mësimore, që detoksimi i fëmijës në veçanti por edhe edukimi dhe qasja e edukimit të fëmijës në përgjithësi, të vijë si rezultat i nxënies së vazhduar prej vetë fëmijës.

Formimi dhe mbrytja e fëmijës, me idenë e ruajtjes së masës së duhur dhe pa e tepruar me praninë e "tre prej katrorëve më të dëmshëm për çilimillëqet: televizori, kompjuteri dhe celulari"<sup>82</sup>, nuk duhet të jenë vetëm një moralizëm, ndërgjegjësim mediatik, çështje të trajtimit social e psikologjik, por duhen konceptuar edhe nën "kopertinën" e një lënde shkollore të mirëdetajuar, siç janë edhe lëndë të tjera të traditës mësimore aktuale. Përmbajtja e lëndëve që zhvillohen në shkollë, është e rëndësishme dhe me një ndikim të padiskutueshëm. Mund të dështohet duke dhënë direktiva të veçanta për edukatorët e të gjithë natyrave, por mund të sigurohet sukses i qëndrueshëm, afatgjatë dhe shpresëdhënës duke i folur drejtpërsëdrejti fëmijëve.

Subjektet, që ngarkon me detyra legjislacioni mbi arsimin parauniversitar, i ndërthurur edhe me legjislacionin mbi të drejtat e fëmijës, i kanë hapësirat e nevojshme për të ndërmarrë një angazhim të thelluar në përmbajtjen kurrikulare, duke parashikuar në atë përmbajtje çfarë e shohim si të rëndësishme dhe urgjente për të ndërhyrë në botëkuptimin e fëmijës. Gandi ka thënë : "Nëqoftëse dëshirojmë të krijojmë një paqe të qëndrueshme, duhet të fillojmë nga fëmijët."

Mund të shkojmë edhe më tej, nëqoftëse dëshirojmë një sistem të qëndrueshëm vlerash e një shoqëri të qëndrueshme, duhet të fillojmë nga

---

<sup>82</sup> Saqellari, Spiro (2011). *Autizmi në këndvështrimin psiko-edukativ*, fq. 24.



fëmijë të lirë e të çliruar nga çdo lloj varësie. Shtetet, shpesh herë kanë ndërhyrë për të mbrojtur në të shkuarën, interesat e fëmijëve. *Ndalimi i punës për fëmijët dhe futja e konceptit të arsimit të detyrueshëm*, dy raste që i takojnë "shtetit dado"<sup>83</sup>, dhe që tashmë janë të normuara e të zakonshme, të dyja erdhën si përgjigje e ndryshimeve të rëndësishme kulturore dhe shoqërore, dhe ishin konsideruar të dyja për kohën e implementimit, si shkelje e madhe e të drejtës prindërore. Ndërhyrja e shtetit që po sugjeroj këtu, nuk është një diktat qeverie dhe as këshillë për rritjen e fëmijëve. Thjesht, shtetet duhet të ndihmojnë për t'i dhënë çdo qytetari, mesazhin e mësuar nga shkenca se si zhvillohen fëmijët dhe për çfarë kanë nevojë ata në faza të ndryshme. Si hap i parë, kjo mund të bëhet nëpërmjet sistemit arsimor.<sup>84</sup>

Edhe një herë, shumëçka mbi përfitim të mirë mbi masën dhe kujdesin e përdorimit të mjeteve të teknologjisë dhe internetit, kulturën e duhur të fëmijëve rreth tyre, detyrë që sot shihet kryesisht si paketë prindërore për t'u përmbushur, me anë të mësimit në shkollë që në fazat më të hershme, mund të vijë natyrshëm e përditshmërisht tek fëmijët, në të mirë të së tashmes dhe të ardhmes së tyre.

---

<sup>83</sup> Shënim: "Nanny State", në anglisht, është termi që përdoret për një qeveri që konsiderohet se ndërhyr më shumë se ç'duhet në zgjedhjet personale.

<sup>84</sup> Palmer Sue, (2007) *Toxic Childhood. How the modern world is damaging our children and what we can do about it?* Fq. 294 - 295

**BIBLIOGRAFI**

Deklarata e të Drejtave të Fëmijës, Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, (1959).

Konventa për të Drejtat e Fëmijës, Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, (1989).

Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, me ndryshimet përkatëse. (2012).

Palmer, Sue (2007) *Toxic Childhood. How the modern world is damaging our children and what we can do about it?*

Saqellari, Spiro (2011). Autizmi në këndvështrimin psiko-edukativ.

Jim Taylor, PhD. *Children's Immersion in Technology is "Shocking" Do you know how much technology your children are using?*

Noti, Kozeta (2013) *Kurrikula dhe aplikimi në tekstet shkollore sipas modeleve bashkëkohore*. Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave sociale, Departamenti i Pedagogjisë dhe i psikologjisë.





UNIVERSITY COLLEGE  
**BEDER**

**Address**

"Jordan Misja" St, Tirana - Albania

Contact: Tel: + 355 4 24 19 222

[www.beder.edu.al](http://www.beder.edu.al), e-mail: [bjh@beder.edu.al](mailto:bjh@beder.edu.al)

